



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 189 / 35 prot.

Tiranë, më 28 . 3 .2024

**NJOFTIM**  
**SHPLLJE PUBLIKE VENDIMI (JR) NR. 51, DATË 12.12.2023**

Subjekti i rivlerësimit: **Dritan Gina**

Në zbatim të neneve 133/a dhe 133/b të K. Pr. Civile, bëhet “Njoftim me shpallje publike” i vendimit (JR) nr. 51, datë 12.12.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Gina.

Ky njoftim së bashku me vendimin do të qëndrojë i afishuar për jo më pak se 20 ditë, në këndin e Njoftimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të botohet në rubrikën “Shpallje” në faqen zyrtare të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>1</sup>.

Shpallja është afishuar sot më datë 28 / 03 /2024  
(Emër, Mbiemër)  
(Nënshkrimi)

( *Jna Xhetani* )



<sup>1</sup> <http://kpa.al/shpallje>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 82/2021 regjistri (JR)  
Datë 21.12.2021

Vendim nr. 51(JR)  
Datë 12.12.2023

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 12.12.2023, ditën e martë, ora 11:40, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Dritan Gina, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 449, datë 22.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nenet 62, 63, 65 dhe 66 pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,



## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Gina (në vijim "subjekti i rivlerësimit") i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim "ILDKPKI"), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim "DSIK"), si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim "KLP"). Komisioni kreu dhe përfundoi hetimin administrativ për dy kritere, vlerësimin e pasurisë dhe kontrollin e figurës.
  - 2.1. Pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit *aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit*<sup>1</sup>, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk është kryer fshehje e pasurisë*; (iv) *është kryer deklarim i rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
  - 2.2. Pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.11.2020, deklasifikuar pjesërisht<sup>2</sup>, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka ndryshuar konstatimin fillestar nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina.
3. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas pikës 5, të nenit 61 të këtij ligji, pasi nuk u tregua bashkëpunues gjatë procesit të hetimit të kryer ndaj tij. Ndërsa në lidhje me kontrollin e figurës, nga ana e Komisionit është vlerësuar i panevojshëm arritja e një konkluzioni, për sa kohë konkluzionet, lidhur me kontrollin e pasurisë dhe qëndrimin e subjektit gjatë procesit, ishin të mjaftueshme për të arritur në vendimin përfundimtar. Në konkluzion, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet A, Ç dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit

<sup>1</sup>Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.11.2017, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Dritan Gina, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë (i komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan)".

<sup>2</sup>Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 09.12.2020, të Komisionit, të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret Shtetëror".



61 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me vendimin nr. 449, datë 22.09.2021, Komisioni vendosi: "Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë".

## II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

4. Kundër vendimit nr. 449, datë 22.09.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Dritan Gina, duke i kërkuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim "Kolegji"):  
(i) kalimin në seancë gjyqësore publike, me qëllim shqyrtimin në prani të palëve të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit; (ii) prishjen e vendimit të Komisionit; dhe (iii) urdhërimin e tij të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit edhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Ankimi i subjektit i rivlerësimit përbëhet nga shkaqe të natyrës procedurale që lidhen me procesin e rregullt ligjor, si dhe pretendime mbi zgjidhjen e themelit të çështjes mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të kontrollit të figurës.
5. Lidhur me aspektet procedurale të procesit të zhvilluar në Komision, si dhe zbatimin e ligjit material, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se është cenuar parimi i gjykimin nga një gjykatë e paanshme, parimi i procesit të rregullt ligjor, gjësë së gjykuar, sigurisë juridike, barazisë para ligjit, si dhe standardi i arsytimit të vendimit, të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në sa vijojnë.
  - 5.1. Njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues në Komision, në kuptim të nenit 122 të Kodit të Procedurës Civile, është absolutisht i pavlefshëm, pasi nuk janë respektuar procedurat ligjore, duke i mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për të ngritur pretendime mbi pengesën, papajtueshmërinë dhe konfliktin e interesit.
  - 5.2. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e komisioneres V. S. është kryer në shkelje të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të datës 08.05.2020, përmes së cilit është vendosur rrëzimi i kësaj kërkesë.
  - 5.3. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e dy komisionereve, E. Ç. dhe Xh. P., është kryer në shkelje të rënda të dispozitave procedurale dhe tej afatit të duhur, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të datës 04.08.2021, përmes së cilit është vendosur rrëzimi i kësaj kërkesë.
  - 5.4. Procedura e shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit e datës 26.07.2021 është kryer në kundërshtim me ligjin dhe vendimi i datës 28.07.2021, përmes së cilit është vendosur rrëzimi i kësaj kërkesë, nuk është produkt i një procesi të rregullt ligjor.
  - 5.5. Vendimet e datës 17.09.2021, të Komisionit, mbi kërkesën për përjashtimin e komisioneres E. Ç. dhe kërkesën për përjashtimin e të gjithë trupit gjykues të Komisionit, janë dhënë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe provat.
  - 5.6. Vendimi i ndërmjetëm i datës 22.01.2020, mbi administrimin e dosjes që i përket subjektit të rivlerësimit R. G., është marrë në kundërshtim me ligjin dhe praktikën e njehsuar të Kolegjit.



5.7. Anëtarët e trupit gjykues në Komision V. S. dhe E. Ç. nuk plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara nga neni 6, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të qenë komisionere të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

5.8. Refuzimi përmes vendimit të ndërmjetëm të datës 14.07.2021 i kërkesës për riçeljen dhe vazhdimin e hetimit administrativ, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe mosshqyrtimi i një tjetër kërkesë të datës 21.09.2021, e bën *nul* procedurën e gjykimit dhe vendimin përfundimtar të Komisionit, si dhe i cenon subjektit të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën për ta kundërshtuar këtë vendimmarrje nëpërmjet ankimit.

5.9. Kryerja e hetimit administrativ për dy kritere rivlerësimi dhe vendimmarrja vetëm mbi një kriter, atë të vlerësimit të pasurisë, e pamundëson subjektin e rivlerësimit nga e drejta për një ankim efektiv, pasi referuar jurisprudencës së Kolegjit subjekti nuk mund të konfirmohet në detyrë, nëse vendimmarrja e Komisionit nuk përfshin të tri kriteret e rivlerësimit.

5.10. Shpallja e vendimit përfundimtar dhe njoftimi i vendimit të arsyetuar janë bërë në shkelje të rënda procedurale pa u respektuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me gjykimin dhe shpalljen e vendimit në mungesë të subjektit të rivlerësimit, tërheqjen e trupit gjykues në dhomë këshillimi përpara shpalljes së vendimit përfundimtar dhe njoftimin e vendimit.


5.11. Konsiderimi i kërkesave procedurale si mungesë bashkëpunimi dhe përpjekje për zvarritjen e gjykimit është shkelje e rëndë procedurale.

5.12. Konkluzioni i Komisionit se [...] *sjellja e subjektit në datën 22.09.2021, ku ka tentuar të hyjë me forcë në sallën, ku zhvillohej seancë dëgjimore, është një sjellje që cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet ndonjë programi trajtimi në Shkollën e Magjistraturës*, përbën një interpretim të gabuar të ligjit, pasi Komisioni nuk ka konkluduar lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale për t'iu referuar programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.

5.13. Komisioni ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit përfundimtar dhe të vendimit të ndërmjetëm të datës 23.07.2021, mbi refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me kopje të raportit të vlerësimit të aftësive profesionale.

5.14. Komisioni ka cenuar parimin e gjësë së gjykuar, sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit, pasi çështjet që kanë të bëjnë me saktësinë e deklaramit të pasurisë, burimin e ligjshëm të krijimit, mënyrën e përfitimit, pagesat e kryera, etj., janë çështje të zgjidhura me vendime të formës së prerë të organeve të drejtësisë dhe nga Komisioni nuk mund të jepej një vlerësim i kundërt. Komisioni ka aplikuar standarde të dyfishta vlerësimi, pasi nuk ka pasur në konsideratë qëndrimet e mbajtura prej tij në raste të tjera, në të cilat ka trajtuar marrëdhënie juridike në kushtet e mirëbesimit, ndërmjet personave me lidhje të ngushta familjare.

6. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nga analizimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit, konstatohet se në të nuk janë ngritur shkaqe ankimore, por pretendime të një natyre të përgjithshme në kundërshtim të çdo konkluzioni të Komisionit, të cilat konsistojnë në sa vijon.



6.1. Për pasurinë, apartament banimi, me sipërfaqe 105 m<sup>2</sup>, në zonën e Shkëmbit të Kavajës, Durrës, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kryer deklaram të saktë dhe ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

6.2. Për pasurinë, apartament banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*\*}” ose “{\*\*\*\*}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kryer deklaram të saktë dhe ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

6.3. Për pasurinë, depozitë në “Credins Bank” ShA, në shumën 10.000 euro

6.3.1. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk mund të vihen në dyshim për sa kohë janë vlerësuar të sakta dhe me burime të ligjshme të mjaftueshme në vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, lënë në fuqi nga Kolegji me vendimin (JR) nr. 12, datë 29.05.2019, që i përket bashkëshortes së subjektit, znj. R. G..

6.3.2. Deklarimi për këtë pasuri është i saktë dhe në përputhje me ligjin, përderisa Komisioni ka arritur në konkluzionin se deklaramet e subjektit në lidhje me këtë depozitë përputhen me dokumentacionin e disponuar nga “Credins Bank” ShA.

6.3.3. Burimet e krijimit të kësaj depozite janë të ligjshme e të mjaftueshme, pasi vlera e saj në datën 23.12.2016, në shumën 10.000 euro, është më e vogël se gjysma e kursimeve të deklaruara rregullisht ndër vite në deklaramet periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja.

6.3.4. Nga të ardhurat dhe kursimet nuk duhet të zbritet shuma 44.400 euro për blerjen e apartamentit në Durrës në vitin 2011, pasi për të është përdorur kredia bankare e marrë për këtë qëllim, si dhe shuma 38.800 USD përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, paguar nga z. N. G..

6.4. Për pasurinë, automjet “Peugeot 308”, deklaramet dhe burimet e krijimit të saj nuk mund të vihen në dyshim, për sa kohë janë vlerësuar të sakta dhe me burime të ligjshme të mjaftueshme në vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, lënë në fuqi nga Kolegji me vendimin (JR) nr. 12, datë 29.05.2019, që i përket bashkëshortes së subjektit, znj. R. G.. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe në përputhje me ligjin, për sa kohë Komisioni ka arritur në konkluzionin se deklaramet e subjektit në lidhje me këtë pasuri përputhen me dokumentacionin e administruar prej tij.

### **III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

#### **A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit**

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa

kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Dritan Gina, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr.84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull kryhet në dhomë këshillimi, sipas përcaktimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 449, datë 22.09.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi mbi bazë të akteve të administruara.

10. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, nëpërmjet së cilës kërkoi që shqyrtimi i çështjes të zhvillohet në seancë gjyqësore publike në prani të palëve dhe administrimin në cilësinë e provës të akteve shpresore të cituara në ankim<sup>3</sup>, të cilat janë paraqitur bashkëngjitur ankimit të paplotë "Për zënien e afatit të ankimit kundër vendimit përfundimtar të Komisionit", protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.11.2021

Për të konkluduar mbi formën e gjykimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe në nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, trupi gjykues vlerësoi të trajtojë në fillim

<sup>3</sup>(i) Artikull i datës 31.05.2021, i botuar në portalin *in-front.org*, gjithsej dy fletë, që denoncon problemet e pamjaftueshmërisë profesionale të komisioneres V. S.; (ii) artikull i datës 18.02.2021, i botuar në portalin *in-front.org*, gjithsej 2 fletë, që denoncon deklaratimet e rreme të pasurisë dhe burimet financiare të paligjshme të komisioneres E. Ç.; (iii) kallëzimi penal i Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion, gjithsej 9 fletë, paraqitur pranë Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ndaj komisioneres E. Ç.; (iv) shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes së cilës ky institucion në përgjigje të një kërkesë të subjektit të rivlerësimit të datës 16.04.2019 me objekt "Krijimin e kushteve fizike të infrastrukturës teknike dhe bazës materiale të nevojshme, për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë", i ka konfirmuar këtë të fundit se ishte në pritje të përgjigjes që do t'i kthehej për këtë rast nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme; (v) shkresë nr. 1087/10 prot., datë 20.01.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku i kërkohet kësaj të fundit krijimi i mundësive për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së prokurorit Dritan Gina; (vi) shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2021, së bashku me aktet në 16 fletë, të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, përmes së cilës ky institucion konfirmon faktin se e-mail-i zyrtar i prokurorit Dritan Gina ka qenë aktiv dhe funksional nga data 21.09.2021 – 11.11.2021.



shkaqet procedurale të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.

10.1. Pretendimi i subjektit se njoftimi i Komisionit mbi përbërjen e trupit gjykues është absolutisht i pavlefshëm, sipas përcaktimeve të nenit 122<sup>4</sup> të Kodit të Procedurës Civile, mbështetet në arsyet si vijojnë: (i) nuk janë respektuar përcaktimet e nenit 46<sup>5</sup> të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 147, 148 dhe 155 të Kodit të Procedurave Administrative<sup>6</sup> mbi mënyrën e njoftimit, duke i mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për të ngritur pretendime mbi pengesën, papajtueshmërinë dhe konfliktin e interesit; (ii) Komisioni duhet të kishte verifikuar më parë pamundësinë e njoftimit elektronikisht të subjektit, për shkak të pezullimit të tij nga detyra e prokurorit, fakt i njohur zyrtarisht dhe publikisht prej tij; (iii) e drejta për të deklaruar konfliktin e interesit me anëtarët e trupit gjykues të Komisionit i është komunikuar 5 muaj e 18 ditë me vonesë nga marrja e detyrës së tij dhe gjatë kësaj periudhe janë kryer hetime në mungesë të njoftimit për fillimin e hetimit administrativ. Në mbështetje të këtyre tri pretendimeve, subjekti i rivlerësimit referon aktet e pezullimit të tij<sup>7</sup> nga detyra e prokurorit në maj të vitit 2018 dhe rikthimit në detyrë në janar të vitit 2020. Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka cituar në ankim dhe ka paraqitur bashkëngjitur *ankimit të paplotë për zënie afati* aktet: (a) shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar prokurorit Dritan Gina; (b) shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 20.01.2020, e Prokurorit të Përgjithshëm “Për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së magjistratit”, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në analizë të këtyre pretendimeve si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, nga aktet e administruara në

<sup>4</sup> Neni 122 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: “Njoftimi është i pavlefshëm kur nuk janë zbatuar dispozitat që kanë lidhje me mënyrën dhe personin të cilit i duhet dorëzuar kopja e aktit ose kur ka pasiguri të plotë për personin ose datën e njoftimit”.

<sup>5</sup> Neni 46 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “1. Njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimit bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji. 2. Nëse subjekti i rivlerësimit është me leje të zakonshme ose me leje lindjeje, njoftimi bëhet në adresën elektronike private që është dhënë në deklaratën e pasurisë, të parashikuar në nenin 31, pika 1, të këtij ligji. 3. Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë dhe është i detyruar të aksesojë e të përdorë adresën elektronike zyrtare gjatë procesit të rivlerësimit. 4. Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative”.

<sup>6</sup> Kodi i Procedurave Administrative në nenin 147 parashikon se: “1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit. 2. Në qoftë se nuk është parashikuar ndryshe me ligj, organi publik është i lirë të vendosë mënyrën e duhur të njoftimit të veprimeve administrative apo ndonjë njoftim tjetër, në kuadrin e procedurës administrative, shqyrtimit të mjeteve ligjore administrative ose procedurës së ekzekutimit të aktit administrativ [...]”.

Në nenin 148 parashikon se: “[...] 2. Një dokument i shkruar mund të njoftohet nëpërmjet dërgimit me postë, mjeteve elektronike, faks apo njoftimit formal, sipas parashikimeve të këtij Kodi”.

Në nenin 155 parashikon se: “1. Njoftimi me postë bëhet nëpërmjet postës së thjeshtë apo të porositur. [...]”.

<sup>7</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2018, Prokurori i Përgjithshëm vendosi pezullimin nga detyra të prokurorit Dritan Gina dhe në bazë të këtij vendimi atij iu ndalua aksesit edhe në adresën zyrtare elektronike e-mail-it; me vendimin e formës së prerë nr. {\*\*\*}, datë 08.11.2018, Gjykata Administrative e Apelit vendosi pranimin e padisë dhe shfuqizimin e vendimeve nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, datë 11.05.2028, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pezullimin nga detyra të prokurorëve R. G. dhe Dritan Gina”; me vendimin gjyqësor penal të formës së prerë nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendosi pushimin e procedimit penal në ngarkim të prokurorëve R. G. dhe Dritan Gina; prokurori Dritan Gina është rikthyer në punë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në muajin shkurt të vitit 2020, në bazë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 20.01.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së magjistratit”.





fashikullin e Komisionin, konstaton se:

10.1.1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Gina është shortuar në datën 12.11.2019, fakt ky i publikuar në faqen zyrtare të Komisionit “Njoftim për shortin e datës 12 nëntor 2019”<sup>8</sup>, ku ndër emrat e 48 subjekteve të rivlerësimit të shortuara në këtë datë, emri i tij renditet i pari në listë.

10.1.2. Trupi gjykues i Komisionit i shortuar në këtë datë pësoi ndryshime nga përbërja e tij fillestare për shkak të heqjes dorë të komisionerit<sup>9</sup> L. H. e më pas anëtares zëvendësuese G. T. (B.). Trupi gjykues i Komisionit u finalizua në datën 06.12.2019 me këtë përbërje: E. Ç. (kryesuese), Xh. P. (relatore) dhe V. S. (anëtare).

10.1.3. Komunikimi i trupit gjykues me subjektin e rivlerësimit ka nisur në datën 10.12.2019, me përcjelljen përmes postës elektronike të njoftimit mbi fillimin e hetimit administrativ, njohjen me përbërjen e trupit gjykues, të drejtën për t’u shprehur mbi konfliktin e interesit, si dhe dërgimin e një pyetësori standard, praktikë kjo e ndjekur për të gjithë subjektet që i janë nënshtruar këtij procesi. Ky njoftim i është dërguar subjektit të rivlerësimit në adresën elektronike personale {\*\*\*}, deklaruar si adresë alternative, sipas shtojcës nr. 3 “Deklarata për kontrollin e figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe jo në adresën zyrtare {\*\*\*} të deklaruar në “Deklaratën e pasurisë”, sipas shtojcës nr. 2 të këtij ligji. I njëjti e-mail i është dërguar subjektit të rivlerësimit më datë 21.04.2020, kësaj here në adresën zyrtare të tij. Po ashtu, ky njoftim i është dërguar subjektit përmes shërbimit postar më datë 28.04.2020, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>10</sup>, njoftim i marrë në dorëzim prej tij sipas lajmërim-marrjes postare, në datë 30.04.2020.

10.1.4. Me marrjen dijeni të këtij njoftimi, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Komisionit përmes shërbimit postar në datën 04.05.2020, me dy kërkesa përjashtimi të anëtarëve të trupit gjykues<sup>11</sup>, e para për përjashtimin e komisioneres V. S., dhe e dyta për përjashtimin e komisionereve Xh. P. dhe E. Ç..

10.1.5. Përmes e-mail-it të datës 07.05.2020, relatorja e çështjes Xh. P. ka informuar trupin gjykues të procesit të rivlerësimit në Komision dhe vëzhguesin ndërkombëtar mbi pamundësinë e komunikimit me subjektin e rivlerësimit, pasi adresa elektronike zyrtare rezultonte jofunksionale dhe komunikimet elektronike nuk arrinin në destinacion, por ktheheshin përsëri. Në këto kushte, komunikimi ishte kryer në rrugë postare në adresën e punës së subjektit të rivlerësimit, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Komisioni ka vijuar përpjekjet për të mundësuar komunikimin elektronik me subjektin e

<sup>8</sup> <https://kpk.al/njoftim-143/11/>

<sup>9</sup> Në datën 19.11.2019 komisioneri L. H. paraqiti kërkesën për dorëheqje nga trupi gjykues i rivlerësimit të subjektit, argumentuar me faktin se ai kishte qenë relator në procesin e rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit, znj. R. G.. Pas pranimit të dorëheqjes së tij, në datën 03.12.2019 komisionerja G. T. (B.), në cilësinë e anëtares zëvendësuese, paraqiti kërkesë për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të subjektit, argumentuar, gjithashtu, me faktin se kishte qenë anëtare e trupit gjykues të znj. R. G.. Pas pranimit të dorëheqjes së komisioneres T. (B.), në datë 06.12.2019 u caktua me short si anëtare e trupit gjykues të rivlerësimit të subjektit, komisionerja E. Ç.

<sup>10</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 28.04.2020, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>11</sup> Kërkesë nr. {\*\*\*} prot., datë 04.05.2020, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020 dhe kërkesë nr. 2, datë 04.05.2020, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020.



rivlerësimi, përmes një tjetër njoftimi<sup>12</sup>, dërguar në rrugë postare në datën 13.05.2020, me lëndë kujtesë mbi disponibilitetin tuaj për të mundësuar komunikimin me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nëpërmjet adresës elektronike, ku i kërkohet aksesimi i postës elektronike në adresën zyrtare të deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe informacion mbi çdo ndryshim adrese me qëllim vazhdimin e komunikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit.

10.1.6. Në datën 18.05.2020, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të mundësuar komunikimin elektronik, i ka drejtuar këtij të fundit përmes shërbimit postar disa pretendime procedurale<sup>13</sup>, në lidhje me mënyrën e njoftimit të përbërjes së trupit gjykues, ku, ndër të tjera, e informon mbi pezullimin e tij për një periudhë të gjatë kohore nga detyra, fakt, sipas tij, i njohur nga Komisioni, pasi ka qenë pikërisht ky institucion, që me nxjerrjen e disa dokumenteve në kundërshtim me ligjin ishte bërë shkak për pezullimin e tij dhe mbylljen për pasojë të adresës elektronike. Nga analizimi i kësaj përgjigjeje, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të jetë shprehur mbi mundësinë aktuale të aksesimit në adresën e tij elektronike, në kushtet e rikthimit në detyrë.

10.1.7. Në kuadër të kërkesave të Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme<sup>14</sup>, më datë 18.06.2020, konfirmoi adresën zyrtare të *e-mail*-it të prokurorit Dritan Gina dhe funksionalitetin e saj, me sqarimin se mbajtja e saj funksionale është përgjegjësi e prokurorit, i cili në rast defektesh duhet të sinjalizojë dhe të kërkojë asistencën teknike të specialistëve të prokurorisë. Më tej, ky institucion ka informuar se një asistencë e tillë nuk është kërkuar nga ana e prokurorit/subjektit, përveç rastiit të muajit maj 2020, ku janë bërë ndërhyrjet për të mundësuar dhënie të aksesit në rrjetin elektronik. Ndërsa Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>15</sup>, më datë 18.06.2020, ka informuar se adresa e prokurorit, subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, ka qenë aktive që nga data 14.05.2020 e në vijim.

10.1.8. Më datë 26.07.2021, subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram pranë Komisionit mbi adresën zyrtare {\*\*\*}, në të cilën mund të mbajë komunikimin gjatë procesit të rivlerësimit dhe disponibilitetin e tij për ta aksesuar atë.

10.1.9. Në analizë të konstatimeve të përmendura më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar. Komisioni ka nisur komunikimin me subjektin e rivlerësimit, duke iu drejtuar atij përmes postës elektronike me njoftimin për nisjen e procesit të rivlerësimit ndaj tij, përbërjen e trupit gjykues dhe të drejtën për të deklaruar konfliktin e interesit. Fakti që ky njoftim i është drejtuar subjektit jo në adresën elektronike të deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë, sikurse përcaktohet specifikisht në pikën 1, të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, por në adresën personale të deklaruar prej tij si adresë alternative dhe e disponueshme, në formularin e kontrollit të figurës, plotësuar po në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk e bën këtë njoftim të pavlefshëm në kuptim të nenit 122 të Kodit të Procedurës Civile. *Së pari*, vetë ligji nr. 84/2016, në pikën 2 të nenit 46, parashikon përdorimin e adresës

<sup>12</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 13.5.2020, e Komisionit, drejtuar subjektit të rivlerësimit.

<sup>13</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 18.05.2020, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2020.

<sup>14</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.202, e Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>15</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë drejtuar Komisionit.



elektronike private, në rastet e mungesës së përkohshme në detyrë të subjektit të rivlerësimit, edhe pse shprehimisht i referohet lejes së zakonshme ose lejes së lindjes, çka nënkupton se procesi i rivlerësimit edhe në këtë rast vazhdon. *Së dyti*, të dyja deklaratat, si ajo e pasurisë, ashtu edhe ajo e figurës, duke qenë shtojca të të njëjtit ligj, kanë të njëjtën peshë sa i takon provueshmërisë dhe vërtetësisë së fakteve të deklaruara në to në funksion të procesit të rivlerësimit e, në këtë kuptim, nuk ka asnjë arsye që të mos besohet që adresa personale e deklaruar në deklaratën e kontrollit të figurës nuk i përket subjektit të rivlerësimit.

**10.1.10.** Në vijim sa më sipër analizuar për këtë pretendim, trupi gjykues vëren se, për shkak të dështimit të njoftimit elektronik, pasi ka konstatuar se adresa elektronike e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si adresë alternative nuk është aksesuar prej tij dhe se adresa zyrtare ka qenë jo funksionale, Komisioni, në zbatim të pikës 4<sup>16</sup>, të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, ka vijuar komunikimin përmes shërbimit postar, si një nga format e përshtatshme të njoftimit të parashikuara në nenin 148 të Kodit të Procedurave Administrative dhe pas këtij njoftimi subjekti konfirmoi marrjen dijëni mbi përbërjen e trupit gjykues të Komisionit në datën 30.04.2020.

**10.1.11.** Pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi pamundësinë e komunikimit elektronik për shkak të pezullimit nga detyra e prokurorit, duke ia ngarkuar Komisionit detyrimin e verifikimit të një fakti të tillë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson si të pabazuar, pasi në analizë të situatës faktike rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte në dijëni të plotë të faktit që, për shkak të ushtrimit të detyrës së prokurorit, si subjekt rivlerësimi do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit duke plotësuar dhe dorëzuar formularët përkatës në tri organet ndihmëse të këtij procesi. Përpos kësaj, si subjekt në pritje të procesit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 3, të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, ishte i detyruar të aksesonte dhe të përdorte adresën elektronike zyrtare gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, ndërsa i ndodhur në kushtet e pezullimit nga detyra e prokurorit mund të aksesonte me kujdes të shtuar adresën e tij personale, të cilën e kishte deklaruar si adresë alternative të disponueshme prej tij, po në funksion të këtij procesi.

**10.1.12.** Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit kundërshton mënyrën e njoftimit të Komisionit mbi trupin gjykues dhe vonesën e marrjes dijëni mbi të, nga ana tjetër ka mbajtur një qëndrim tërësisht pasiv duke vështirësuar komunikimin me Komisionin. Nga aktet në dosje gjyqësore, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit përpara datës 18.05.2020 nuk ka komunikuar me Komisionin për ta informuar mbi rrethanat e pezullimit apo rikthimin e tij në detyrë, për t'i paraprirë në këtë mënyrë çdo mungese njoftimi. Po ashtu, pas rikthimit në detyrë, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, në janar të vitit 2020, subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë masa për të sinjalizuar problematikat me adresën e *e-mail*-it, sikurse konfirmon organi i prokurorisë, ndërkohë adresa e tij vijoi të ishte jofunksionale deri në datën 14.05.2020.

**10.1.13.** Lidhur me pretendimin mbi vonesën në njoftimin e përbërjes së trupit gjykues të Komisionit dhe mohimit të së drejtës për t'u shprehur mbi konfliktin e interesit me anëtarët e tij, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ligji nr. 84/2016, në nenin 27 të tij, garanton të drejtat e palëve për një proces të paanshëm, duke parashikuar mundësinë e përjashtimit të një anëtari të

<sup>16</sup> Pika 4 e nenit 46 të ligjit parashikon se: "Në rast se njoftimi nuk realizohet sipas parashikimeve të mësipërme, mund të përdoren forma të tjera të komunikimit, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative".



trupit gjykues, kur ekzistojnë shkaqe papajtueshmërie, sipas nenit 30 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Pavarësisht se këto dispozita ligjore nuk parashikojnë afat të posaçëm për komunikimin e përbërjes së trupit gjykues, ky njoftim ka qenë ndër veprimet e para procedurale të ndërmarra nga Komisioni menjëherë pas finalizimit të përbërjes së trupit gjykues, realizuar përmes shërbimit postar në zbatim të dispozitave ligjore. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, me marrjen dijani më datë 30.04.2020 të përbërjes së trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën për t’u shprehur mbi konfliktin e interesit, duke kërkuar me anë të dy kërkesave të datës 04.05.2020 përjashtimin e komisioneres V. S. dhe dy komisionereve Xh. P. dhe E. Ç.. Këto kërkesa janë shqyrtuar nga dy trupa gjykuese të caktuara me short, duke garantuar një proces ligjor të rregullt e të paanshëm, sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016.

10.1.14. Lidhur me pretendimin se Komisioni ka kryer veprime hetimore ende pa marrë dijani subjekti i rivlerësimit mbi fillimin e hetimit administrativ ndaj tij, trupi gjykues i Kolegjit nga aktet në dosjen gjyqësore konstaton se në datën 30.04.2020 subjekti i rivlerësimit ka marrë dijani mbi nisjen e procesit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupit gjykues, ndërkohë që veprimet<sup>17</sup> e kryera nga Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ deri në këtë datë, për nga natyra e tyre, konsiderohen veprime të përgjithshme standarde të ndjekura për të gjithë subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, pavarësisht përbërjes së trupit gjykues që do t’i merrte në shqyrtim. Nga ana tjetër, përgjigjet e administruara në këtë drejtim nuk iu nënshtrohen ndonjë vlerësimi nga ana e trupit gjykues dhe nuk kanë shërbyer për vendimmarrjen. Po kështu, dosja e procesit të rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit, znj. R. G., nuk i është nënshtuar ndonjë vlerësimi deri në atë moment, pasi tërheqja e saj është bërë më datë 08.09.2020, rrethanë që nuk afekton paanësinë e Komisionit.

10.1.15. Në vijim, edhe shkresat kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 23.04.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>18</sup> dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 20.01.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së magjistratit” drejtuar Prokurorisë

<sup>17</sup> (i) Kërkesë për informacion drejtuar bankave, protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 21.04.2020; (ii) përgjigje nga Porsche Leasing ShPK protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.04.2020; (iii) përgjigje nga “ProCredit Bank” ShA protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 28.04.2020; (iv) përgjigje nga “Fibank Albania” ShA protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.04.2020; (v) përgjigje nga “Raiffeisen Bank” ShA protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 15.4.2020; (vi) përgjigje nga “Union Bank” ShA protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.04.2020; (vii) përgjigje nga “Unioni Financiar Tiranë” ShA protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2020; (viii) përgjigje nga “Banka Amerikane e Investimeve” ShA protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 3.4.2020; (ix) kërkesë për deklasifikim dhe rishikim raporti drejtuar DSIK protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 10.12.2019; (x) vendim i trupit gjykues, datë 22.01.2020, për administrimin e dokumenteve nga dosja e subjektit të rivlerësimit R. G..

<sup>18</sup> Përmes kësaj shkrese kjo prokurori, në përgjigje të kërkesës së subjektit Dritan Gina “Për krijimin e kushteve fizike të infrastrukturës teknike dhe bazës materiale të nevojshme, për vazhdimin e ushtrimit të detyrës së prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, informon se ky institucion dispononte vetëm urdhrin e datës 11.05.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e tij nga detyra e prokurorit dhe jo urdhër për vënien në ekzekutim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila kishte vendosur shfuqizimin e urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin nga detyra.



pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë<sup>19</sup>, që subjekti i rivlerësimit kërkon të merren në cilësinë e provës, edhe nëse do të plotësonin kriteret formale të pranueshmërisë së përcaktuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësohen nga trupi gjykues si prova të panevojshme e, për pasojë, u refuzuan nga Kolegji, bazuar në parashikimin e nenit 49, pika 6, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016.

10.1.16. Bazuar në sa sipërarsyetuar, trupi gjykues i Kolegjit i konsideron si të pambështetura në fakte dhe në ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit për gjykim nga një gjykatë e paanshme në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

10.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se procedura e shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e komisioneres V. S. është zhvilluar në shkelje të rënda të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të datës 08.05.2020, përmes së cilës është vendosur rrëzimi i kësaj kërkesë, për këto arsye: (i) trupi gjykues ka zhvilluar seancë dëgjimore me komisioneren V. S., për të cilën ishte kërkuar përjashtimi, duke cenuar kështu parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit dhe duke e privilegjuar atë; (ii) shqyrtimi i kërkesës për përjashtim gjyqtari duhet të bëhet nga trupi tjetër gjykues në dhomë këshillimi, ndërkohë që sipas subjektit kjo kërkesë është shqyrtuar në katër mbledhje, dy të zhvilluara në datën 07.05.2020 dhe dy në datën 08.05.2020 dhe *mbledhja* nuk përbën procedurë ligjore për shqyrtimin e çështjeve para trupave gjyqësore. Në shqyrtim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues nga analizimi i akteve të administruara në fashikullin e Komisionit, konstaton se:

10.2.1. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2020, administruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020, nëpërmjet të cilës ka kërkuar përjashtimin e komisioneres V. S. nga përbërja e trupit gjykues, për arsye se: (i) ka paragjykuar çështjen e subjektit të rivlerësimit dhe është e njëanshme, pasi duke qenë pjesë e trupit gjykues i ka mohuar atij për një periudhë prej 5 muaj e 18 ditësh të drejtën për njohjen me trupin gjykues; (ii) nuk ka deklaruar konfliktin e interesit dhe nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim për t'u përjashtuar nga trupi gjykues, duke e hetuar kështu subjektin për një periudhë prej 5 muaj e 18 ditësh; (iii) ka pengesë për të qenë në përbërjen e trupit gjykues, pasi ka shqyrtuar kërkesa procedurale dhe ka marrë vendim për çështje që i përkasin procesit të rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit R. G.; (iv) ka njohje të fakteve dhe rrethanave të rëndësishme të procesit të rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit; (v) vendimi i saj, për mospërjashtimin e trupës së themelit të subjektit të rivlerësimit R. G., ishte vendimi procedural vendimtar që çoi në shkarkimin nga detyra të bashkëshortes së tij.

10.2.2. Kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga një trup gjykues i caktuar me short<sup>20</sup>, i cili u mbledh 4 (katër) herë, për trajtimin e kërkesës, përkatësisht nga dy herë në datat 07.05.2020 dhe 08.05.2020.

10.2.3. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë, trupi gjykues ka ndërmarrë veprimet si vijojnë:

<sup>19</sup> Përmes kësaj shkrese, Prokurori i Përgjithshëm i kërkon Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë si organ kompetent, për të bërë të mundur vazhdimin e ushtrimit të detyrës së prokurorit Dritan Gina, duke qenë se nuk ekzistojnë më shkaqe ligjore që të pengojnë ushtrimin e detyrës së tij.

<sup>20</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.05.2020, të Komisionit, u ngrit trupi gjykues i përbërë nga komisionerët R. I. dhe B. B..



(i) zhvilloi seancën dëgjimore me komisioneren V. S.; (ii) administroi praktikën e vendimit të ndërmjetëm nr. {\*\*\*} prot., datë 11.07.2018, të trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën procedurale të subjektit të rivlerësimit R. G.; (iii) mblodhi informacion nga trupi gjykues i procesit të rivlerësimit mbi veprimet procedurale të ndjekura nga ky i fundit, lidhur me njoftimin e përbërjes së tij subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të këtyre veprimeve, me vendimin e datës 08.05.2020, trupi gjykues i Komisionit vendosi rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit. Vendimi i arsyetuar iu komunikua subjektit përmes shërbimit postar në adresën pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>21</sup>.

**10.2.4.** Në analizë të konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kërkesa e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e komisioneres V. S. është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 27, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 19 e 20 të Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Në vlerësimin e Kolegjit, seanca dëgjimore me komisioneren V. S. është zhvilluar në përputhje me nenin 75, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se *gjyqtari, për të cilin kërkohet përjashtimi, ka të drejtë të paraqesë qëndrimin e tij me shkrim në lidhje me këtë kërkesë*. Lidhur me këtë fakt, përkundër sa pretendohet nga subjekti, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo dispozitë parashikon një të drejtë dhe jo detyrim për anëtarin e trupit gjykues, ku në rastin konkret komisionerja V. S. qëndrimin e saj e ka mbajtur duke u dëgjuar në seancë dëgjimore e, në këto kushte, ky aspekt procedural konsiderohet i tejkaluar. Ndërsa sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, lidhur me përdorimin e termit *mbledhje*, që, sipas tij, nuk përbën procedurë ligjore, duket se ky term i përdorur në komunikimet e trupës gjyqësore, përmes shprehjeve të tilla si *trupi gjykues në mbledhjen e mbajtur sot, datë [...] ndër të tjera vendosi* apo në procesverbale përmes shprehjeve të tilla si *[...] trupi gjykues në mbledhje vendosi*, nuk e cenon në asnjë rast dhe në asnjë lloj forme procedurën e shqyrtimit të kërkesës së subjektit për përjashtim.

**10.2.5.** Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioni, për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres V. S., është në përputhje me ligjin dhe nuk e cenon vlefshmërinë e vendimit të ndërmjetëm të datës 08.05.2020, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit.

**10.3.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimin se procedura e shqyrtimit të kërkesës nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2020, për përjashtimin e dy komisionereve E. Ç. dhe Xh. P., është zhvilluar në shkelje të rënda të normave procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit të datës 04.08.2021, përmes së cilit është rrëzuar kjo kërkesë, i cili ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar, për arsytet si vijojnë: (i) kërkesa nuk u shqyrtua në mënyrë të rregullt dhe në kohën e duhur, por 15 muaj pas paraqitjes së saj, në kundërshtim me Rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, që parashikon se shqyrtimi i kërkesave për përjashtim gjyqtari duhet të bëhet brenda një afati 5- ditor nga paraqitja e tyre. Mosshqyrtimi në kohë ngre dyshimin mbi mungesën e paanësisë në gjykim; (ii) vendimi për kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtim është marrë në kundërshtim me nenin 9 të Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” dhe pa respektuar

<sup>21</sup> Shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 12.05.2020, drejtuar subjektit të rivlerësimit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



procedurat e hedhjes së shortit, sipas neneve 15 dhe 20 të kësaj rregulloreje dhe rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, shkak për pavlefshmëri, sipas vendimit nr. 2, datë 24.01.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>22</sup>. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

**10.3.1.** Më datë 05.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë<sup>23</sup> për përjashtimin e komisionerëve Xh. P. dhe E. Ç. nga përbërja e trupit gjykues, për të njëjtat arsye si ato të pretenduara në kërkesën për përjashtimin e komisioneres V. S..

**10.3.2.** Kërkesa për përjashtimin e dy komisionerëve, pavarësisht se ishte depozituar në të njëjtën datë me kërkesën për përjashtimin e komisioneres V. S., rezultoi e pa shqyrtuar deri në momentin kur përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore të datës 26.07.2021 bëri prezent mungesën e një vendimmarrjeje lidhur me të. Në kushtet kur kryesuesja e trupit gjykues E. Ç. nuk ishte në dijeni të një kërkesë të tillë, me qëllim verifikimin e administrimit të saj pranë zyrës së protokollit të Komisionit, kërkoi disa minuta pushim. Me rinisjen e seancës dëgjimore, kryesuesja informoi se nuk rezultonte të ishte depozituar një kërkesë e tillë. Mungesën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit e bën pjesë të pretendimeve të tij në një kërkesë tjetër të paraqitur gjatë seancës dëgjimore, në këtë rast me objekt përjashtimin e të gjithë trupit gjykues të Komisionit.

**10.3.3.** Trupi gjykues i shortuar për shqyrtimin e kërkesës<sup>24</sup> së paraqitur gjatë seancës dëgjimore, pas verifikimeve të kryera, konstatoi se kërkesa e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për përjashtimin e dy komisionereve ishte administruar pranë Komisionit në të njëjtën datë me kërkesën për përjashtimin e komisioneres S., por për të nuk kishte një vendimmarrje. Në këto kushte, ky trup gjykues i drejtohet kryetares së Komisionit dhe Mbledhjes së Komisionit me një memo<sup>25</sup>, në të cilën, duke e informuar se ky trup gjykues kishte dalë me vendimmarrje vetëm për kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, për të cilin ishte ngritur, kërkoi thirrjen e mbledhjes së Komisionit për të vlerësuar situatën në tërësi, lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e dy komisionerëve.

**10.3.4.** Komisioni, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.07.2021, vendosi ngritjen e trupit gjykues<sup>26</sup> për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e komisionerëve Xh. P. dhe E. Ç.. Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, Komisioni shprehet se [...] vlerëson të theksojë se, pavarësisht se rezultoi i provuar depozitimi fizik i dokumentit në protokollin e institucionit, Kryetari është vënë në dijeni de jure në datën 29.07.2021, pas konstatimit të faktit të ekzistencës së kërkesës nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2020, protokolluar me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020 nga trupi gjykues

<sup>22</sup> Në vendimin nr. 2, datë 24.01.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë parashikohet se: “Mosrespektimi i procedurave të shortit për caktimin e trupës gjyqësore në gjykimin e një çështje konkrete, përbën shkelje të së drejtës së njeriut për tu gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe sjell pavlefshmërinë e vendimit të marrë nga kjo trupë”.

<sup>23</sup> Kërkesë e subjektit të rivlerësimit nr. {\*\*\*}, datë 04.05.2020, protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020.

<sup>24</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2021, i Komisionit, për caktimin e trupit gjykues të përbërë nga komisionerët F. Sh., O. K. dhe B. B.

<sup>25</sup> Memo e protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 29.07.2021.

<sup>26</sup> Trupi gjykues i përbërë nga komisionerët F. Sh., G. T. (B.) dhe P. Q..



*i ngritur me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.7.2021 [...]. Në kushtet kur procesi i rivlerësimit të subjektit nuk ka përfunduar ende, duke e çmuar si një rrethanë përjashtimore mosshqyrtimin e kësaj kërkesë brenda afatit të përcaktuar me ligj, si dhe për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, kërkesa duhet të merret në shqyrtim nga një trup gjykues i ngritur me short.*

**10.3.5.** Trupi gjykues i shortuar për shqyrtimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e dy komisionerëve, me vendimin e datës 04.08.2021, vendosi rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ky vendim i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 19.08.2021.

**10.3.6.** Trupi gjykues i Kolegjit, referuar akteve të mësipërme, vëren se kërkesa e paraqitur nga subjekti që në datën 05.05.2020 është marrë në shqyrtim dhe është rrëzuar nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short. Pavarësisht shqyrtimit të kërkesës pas një periudhe prej 1 vit e tre muajsh, nga paraqitja e saj, në tejkalim të afateve procedurale të parashikuara nga neni 20, pika 2<sup>27</sup> e Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se nga kjo vonesë nuk rezulton të jetë cenuar ndonjë e drejtë e subjektit të rivlerësimit që do të afektonte parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi të gjitha kërkesat për përjashtim janë shqyrtuar përpara vlerësimit dhe vendimmarrjes së Komisionit mbi themelin e çështjes që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Gina. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit konstaton një qëndrim pasiv të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë kërkesë duke e ngritur si problematikë vetëm në momentin përfundimtar të procesit të rivlerësimit, sikurse është seanca dëgjimore dhe duke e përdorur më pas si shkak përjashtimi për gjithë trupin gjykues e duke demonstruar në këtë mënyrë një përpjekje për zvarritje të procesit të rivlerësimit.

**10.3.7.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimin për kalimin e kësaj kërkesë për shqyrtim e ka marrë “Mbledhja e Komisionit” pa ndjekur procedurën e hedhjes së shortit përcaktuar në nenet 15 dhe 20 të Rregullores “Mbi veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” dhe Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se neni 27, pika 3<sup>28</sup> e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 20, pika 1<sup>29</sup> e Rregullores “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, parashikojnë detyrimin e caktimit me short të një trupi gjykues, pa qenë nevoja për diskutime apo vlerësime paraprake të Mbledhjes së Komisionit. Pavarësisht se kërkesa për përjashtimin e dy komisionerëve duhet t’i ishte përcjellë Kryetarit të Komisionit për organizimin e procedurës së shortit për caktimin e trupit gjykues që do ta shqyrtonte atë dhe jo mbledhjes së Komisionit për të vlerësuar situatën në tërësi, Kolegji konstaton se procedura e shortit është zhvilluar nga Kryetari i Komisionit dhe kërkesa për përjashtimin është marrë në shqyrtim nga trupi gjykues i shortuar për këtë qëllim, sipas nenit 27 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>27</sup> Në nenin 20, pika 2 e Rregullores përcaktohet se: “Trupa gjykuese e caktuar me short sipas pikës 1 të këtij neni merr vendim për përjashtimin ose jo të anëtarit të trupës gjykuese brenda 5 ditëve nga caktimi i çështjes me short.

<sup>28</sup> Në nenin 27, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se: “3. Çdo person, i cili ka informacion mbi ekzistencën e shkaqeve të konfliktit të interesit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, njofton menjëherë me shkrim trupin gjykues, i cili ia përcjell kërkesën për vendim një trupi tjetër gjykues, të caktuar me short”.

<sup>29</sup> Në nenin 20, pika 1 e Rregullores përcaktohet se “1. Trupa gjykuese e njoftuar sipas nenit 15, me marrjen e kërkesës nga njëri prej anëtarëve të saj apo nga çdo person tjetër, sipas pikës 3 të këtij neni, njofton menjëherë kryetarin, i cili organizon procedurën e shortit për caktimin e trupës gjykuese që do të shqyrtojë kërkesën për përjashtimin ose jo të anëtarit nga procedura”.





10.3.8. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioni, për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e dy komisionereve Xh. P. dhe E. Ç., nuk ka shkaktuar shkelje të të drejtave të subjektit të rivlerësimit, sepse është marrë në shqyrtim përpara se trupi gjykues i Komisionit të futej në bisedime për marrjen e vendimit.

10.4. Subjekti i rivlerësimit në ankim ngre pretendimin se kërkesa për përjashtimin e trupit gjykues e datës 26.07.2021 nuk është shqyrtuar sipas ligjit dhe vendimi i Komisionit i datës 28.07.2021, për rrëzimin e saj, nuk është produkt i një procesi të rregullt, për arsye se: (i) argumentet e komisioneres Xh. P. nuk janë dhënë me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 75, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, por verbalisht në dhomë këshillimi; (ii) shqyrtimi i kërkesës për përjashtim, konfirmimi dhe vërtetimi i fakteve është bërë në prani të trupit gjykues të hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit, për të cilin ishte kërkuar përjashtimi, duke bërë që trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim të ketë qenë nën ndikimin dhe sugjestionimin e trupës, për të cilën ishte kërkuar përjashtimi. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti referon paragrafët 17 dhe 18, të vendimit të datës 28.07.2021, për rrëzimin e kërkesës për përjashtim. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit dhe konstaton se:

10.4.1. Ashtu si përmendur më sipër, në përfundim të seancës dëgjimore të datës 26.07.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues<sup>30</sup> duke e konsideruar atë jo të rregullt dhe të njëanshëm, për dy arsye se: (i) për shkak të mungesës së shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues të depozituar prej tij në datën 05.05.2020 dhe vendimmarrjes lidhur me të; (ii) për shkak se anëtarja e trupës Xh. P. ndodhej në kushtet e pengesës ligjore dhe të konfliktit të interesit, pasi ka qenë në dy raste në marrëdhënie klient-avokat, me përfaqësuesin ligjor të subjektit të rivlerësimit, z. E. B..

10.4.2. Kjo kërkesë u mor në shqyrtim nga një trup gjykues i caktuar me short<sup>31</sup>, i cili në datën 28.07.2021, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar dhe sekretares gjyqësore, dëgjoi shpjegimet e punonjësës së protokollit, znj. D. N., komisioneres Xh. P., kryetares P. Q. dhe ish-kryetares G. T. (B.), asokohe kryetare. Punonjësja e protokollit, znj. N., ka deklaruar<sup>32</sup> se kërkesa për përjashtimin e komisioneres V. S. dhe ajo për përjashtimin e dy komisionereve Xh. P. dhe E. Ç., për shkak të një gabimi njerëzor, janë regjistruar me një numër protokollit, pasi nga ngjashmëria në formatin e tyre dhe fakti që i përkasin të njëjtit subjekt rivlerësimi Dritan Gina janë konsideruar kopje të së njëjtës kërkesë. Komisioneret P. Q. dhe G. T. (B.), përkatësisht në cilësinë e kryetares dhe ish-kryetares asokohe, sqaruan procedurën që ndiqej, lidhur me regjistrimin e kërkesës e trajtimin në vijim, duke qartësuar se kërkesa i dorëzohej kryetarit, i cili thërriste më pas mbledhjen e Komisionit, në mënyrë që të përcaktohej me short trupi gjykues që do të shqyrtonte kërkesën. Ndërsa komisionerja Xh. P., njëkohësisht relatore në çështjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, u shpreh se për këtë kërkesë kishte marrë dijeni vetëm një ditë më parë nga trupi gjykues që po kryente verifikime lidhur me kërkesën, ndërkohë që lidhur me pretendimin e dytë të subjektit të rivlerësimit ajo u shpreh se fakti që ka

<sup>30</sup> Kjo kërkesë është protokolluar nga Komisioni me nr. {\*\*\*} prot., datë 27.07.2021.

<sup>31</sup> Ky trup gjykues është caktuar me short me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.07.2021.

<sup>32</sup> Procesverbali i mbledhjes së trupit gjykues të caktuar me shortin e datës 28.07.2021.



pasur shok klase avokatin e tij apo çdo aspekt tjetër lidhur me avokatin nuk përbën shkak për përjashtimin e saj, në kuadër të një konflikti interesi.

10.4.3. Me vendimin e datës 28.07.2021, trupi gjykues i Komisionit ka vendosur refuzimin e kërkesës për përjashtimin e të gjithë trupit gjykues të hetimit administrativ, duke arsyetuar se 17. Lidhur me pretendimin e subjektit për depozitimin e kërkesës për përjashtimin e dy anëtarëve/komisionere Xh. P. dhe E. Ç., në mbledhjen e trupit me praninë e punonjësit të arkiv-protokollit dhe të trupës gjykuese për hetimin administrativ të subjektit të rivlerësimit, u konfirmua se kërkesa e datës 04.05.2020 është depozituar nga subjekti i rivlerësimit në rrugë postare dhe është marrë në dorëzim nga sektori përkatës në datën 05.05.2020. Gjithashtu u vërtetua se anëtarët e trupit gjykues nuk kanë qenë në dijeni të kësaj kërkesë dhe nuk janë bërë shkak për mosmarrjen në shqyrtim të saj. Ky vendim i është njoftuar subjektit përmes postës elektronike në datën 30.07.2021<sup>33</sup>.

10.4.4. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të konstatimeve të mësipërme, vlerëson se kërkesa e subjektit të rivlerësimit, e paraqitur në mbyllje të seancës dëgjimore të datës 26.07.2021, është marrë në shqyrtim nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short, sipas përcaktimeve të nenit 27, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe neneve 15 dhe 20, pika 2<sup>34</sup> të Rregullores “Mbi veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Në lidhje me pretendimin se komisionerja Xh. P. nuk e ka dhënë mendimin e saj me shkrim, por është dëgjuar në seancë dëgjimore, Kolegji vlerëson se seanca dëgjimore me komisioneren Xh. P. është zhvilluar në përputhje me nenin 75, paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se *gjyqtari për të cilin kërkohet përjashtimi, ka të drejtë të paraqesë qëndrimin e tij me shkrim në lidhje me këtë kërkesë*. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, kjo dispozitë ligjore parashikon një të drejtë dhe jo detyrim për anëtarin e trupit gjykues për të shprehur qëndrimin e tij me shkrim dhe, në rastin konkret, komisionerja Xh. P. ka zgjedhur të dëgjohet në seancë dëgjimore.

10.4.5. Lidhur me pretendimin e dytë të subjektit, nga analizimi i procesverbalit të datës 28.07.2021, evidentohen faktet e njoftimit, mbërritjes dhe largimit të komisioneres Xh. P., pasqyruar në këtë procesverbal përmes shprehjeve si vijojnë: *Njoftohet komisionere Xh. P. [...], [...] vjen komisionere Xh. P. në sallë dhe largohet nga salla komisionere Xh.* Më konkretisht, konstatohet se, pasi përfundon dëgjesa me znj. D. N., njoftohet për të ardhur në sallë komisionerja Xh. P., e cila vjen, jep qëndrimin e saj lidhur me pretendimin e subjektit për konflikt interesi, më pas mbi kërkesën e patrajtuar të datës 05.05.2020 dhe pas përfundimit të pyetjeve ajo largohet. Ndërkaq, pas këtij momenti në procesverbal evidentohet fakti i paraqitjes së kryetares së Komisionit P. Q., duke u pasqyruar si vijon: *Paraqitet Kryetarja e Komisionit P. Q.*, e cila jep sqarime mbi mënyrën e trajtimit të kërkesave për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues dhe në fund të fjalës së saj ajo largohet, evidentuar ky fakt me shprehjen *(largohet kryetarja nga salla dhe thërritet komisionere G. T. (B.))*. Referuar përmbajtjes së procesverbalit, gjatë kohës që komisionere Xh. P. ka qenë e pranishme në sallën e mbledhjes, asaj i janë drejtuar pyetje nga trupi gjykues, por asnjë nga anëtarët e trupës nuk ka dhënë

<sup>33</sup> E-mail i datës 30.07.2021 mbi njoftimin e vendimit të trupit gjykues drejtuar subjektit.

<sup>34</sup> Neni 20, pika 2 përcakton se: “Trupa gjykuese e caktuar me short sipas pikës 1 të këtij neni merr vendim për përjashtimin ose jo të anëtarit të trupës gjykuese brenda 5 ditëve nga caktimi i çështjes me short”.



vlerësime mbi situatën. Pas largimit të saj, anëtarët e trupit gjykues të caktuar me short kanë vijuar diskutimin e tyre dhe kanë arritur në vendimmarrje.


10.4.6. Në vijim të analizimit të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është fakt që, përkundër sa pasqyrohet në paragrafin 17 të vendimit të datës 28.07.2021 të cituar nga subjekti i rivlerësimit, referuar procesverbalit të kësaj date, nuk evidentohet prania e trupit gjykues të hetimit administrativ në diskutimet e trupit gjykues të caktuar me short për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se referuar nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile, akti procedural, i cili dokumenton<sup>35</sup> pjesëmarrjen, ngjarjen dhe çështjet e diskutuara, është procesverbali dhe, në këtë kuptim, vlerësohet se faktet e dokumentuara nga ky akt duhet të ishin paraqitur në mënyrë të saktë në vendim nga ana e trupit gjykues, pasi një mospasqyrim i tillë jo i saktë i ka krijuar subjektit të rivlerësimit perceptimin se kërkesa e tij është trajtuar në pranë të trupës së rivlerësimit.

10.4.7. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit se trupi gjykues i caktuar për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim ka qenë nën ndikimin dhe sugjestionimin e trupit gjykues, për të cilin ishte kërkuar përjashtimi, Kolegji vlerëson se shprehja e përdorur në paragrafin 18 të vendimit të datës 28.07.2021 se [...] trupi gjykues vlerësoi të bazuar argumentin e komisioneres Xh. P. se nuk është në asnjë nga kushtet e konfliktit të interesit, sipas nenit 30 të Kodit të Procedurës Administrative nuk tregon që vendimi i trupit gjykues është mbështetur apo bazuar tek argumenti i komisioneres Xh. P., por se vlerësimi i tij për rastin konkret përputhet me qëndrimin e saj. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se procedura e ndjekur nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues është në përputhje me ligjin dhe se mospërputhja mes vendimit të datës 28.07.2021 dhe procesverbalit të trupit gjykues në këtë datë, lidhur me pasqyrimin e gabuar në vendim të faktit të prezencës në mbledhje të trupit gjykues të procesit të rivlerësimit, vlerësohet se nuk e cenon vlefshmërinë e vendimit të datës 28.07.2021.

10.5. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se dy vendimet e Komisionit të datës 17.09.2021, mbi kërkesën për përjashtimin e komisioneres E. Ç. dhe mbi kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të procesit të rivlerësimit, janë dhënë në kundërshtim të hapur me ligjin dhe provat e, si të tilla, duhet të ndryshohen nga Kolegji duke prishur vendimin nr. 449, datë 22.09.2021, të Komisionit. Në analizë të këtij pretendimi, nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

10.5.1. Në seancën dëgjimore të datës 15.09.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy

<sup>35</sup> Neni 118 "Procesverbali" i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: "[...] Procesverbali duhet të tregojë: (a) vendin ku zhvillohet veprimi procedural gjyqësor; (b) kohën e zhvillimit të veprimit procedural gjyqësor; (c) përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit të gjykatës; (ç) gjeneralitetet e pjesëmarrësve në gjykim; dhe (d) personat e thirrur, që nuk janë paraqitur, si dhe, nëse dihet, arsyen e mungesës së tyre. Procesverbali duhet të përshkruajë veprimet procedurale të kryera gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë fjalë për fjalë: (a) të gjitha kërkatet dhe kundërshtimet e palëve dhe të personave të tretë; (b) përmbledhjen e saktë të çdo shpjegimi dhe pretendimit me shkrim të paraqitur nga pala; (c) pyetjet dhe thëniet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët; (ç) provat e marra, duke përfshirë përmbajtjen e provave me shkresë që janë paraqitur, të shiritave të magnetofonit, diapozitivave e filmave; (d) të gjitha vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit; dhe (dh) të gjitha pretendimet përfundimtare të palëve [...]".



kërkesa, njërën për përjashtimin e komisioneres E. Ç. dhe tjetrën për përjashtimin e trupit gjykues të çështjes.

a) Në kërkesën për përjashtimin e komisioneres E. Ç., subjekti i rivlerësimit pretendon se komisionerja nuk është e pavarur dhe nuk garanton një proces të rregullt ligjor, pasi ndodhet nën ndikimin dhe presionin e z. B. Zh., për shkarkimin nga detyra të prokurorit Dritan Gina. Këtë rrethanë subjekti i rivlerësimit e lidh me faktin se z. B. Zh. ka sjellë në Shqipëri dhe ka ndjekur zbatimin e projektit norvegjez “{\*\*\*}”, në Devoll dhe komisionerja E. Ç. ka punuar pranë kësaj kompanie për periudhën 2009-2017, fakt që, sipas subjektit, konfirmon marrëdhënien e punës dhe njohjen 18-vjeçare të saj me z. B. Zh., i cili ka shantazhuar subjektin e rivlerësimit gjatë një interviste në televizion pak përpara nisjes së seancës dëgjimore të datës 03.09.2021<sup>36</sup>. Për të mbështetur pretendimet e tij, bashkëlidhur kësaj kërkesë, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës aktet: (i) informacion mbi karrierën profesionale të komisioneres E. Ç., publikuar në faqen zyrtare të Komisionit; (ii) intervistën e z. B. Zh. publikuar në portalin *dosja.al*; (iii) një CD e intervistës së biznesmenit B. Zh. dhënë për emisionin “{\*\*\*}” në kanal televiziv {\*\*\*}, titulluar “*Bomba e biznesmenit, prokurori Dritan Gina më gjobiti me 30 mijë euro*”; (iv) ekstrakt historik të regjistrimit tregtar për shoqërinë “{\*\*\*}”, nxjerrë nga faqja e QKB-së.

b) Në kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) me vendimin e ndërmjetëm të datës 15.09.2021, trupi gjykues i kishte kufizuar afatin treditor të parashikuar nga neni 75 i Kodit të Procedurës Civile për paraqitjen me shkrim të kërkesës për përjashtim, çka sjell paragjykimin e çështjes; (ii) në kundërshtim me nenet 72 dhe 74 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues nuk e ndërpreu seancën dëgjimore, për t’i garantuar subjektit të drejtën për të paraqitur me shkrim kërkesën për përjashtim, mbi shkaqet e reja që lindën në seancë dëgjimore dhe shqyrtimin e kërkesës nga një trupë tjetër gjyquese, por vazhdoi procesin në kushtet e pengesës ligjore, duke marrë vendime të rëndësishme lidhur me procesin e hetimit e duke krijuar dyshimin për paragjykim të çështjes; (iii) trupi gjykues nuk u shpreh menjëherë lidhur me kërkesën e subjektit për përsëritjen e hetimit administrativ, për shkak të nulitetit të hetimit për periudhën nga 04.05.2020 e deri në datën 04.08.2021; (iv) kërkesat procedurale që lidhen me hetimin gjyqësor dhe që kanë lidhje direkte me vendimmarrjen përfundimtare nuk janë çështje që mund të trajtohen në vendimmarrjen përfundimtare; (v) komisionerja E. Ç., në seancën dëgjimore të datës 15.09.2021, u shpreh mbi kërkesën që lidhej me përjashtimin e saj si anëtare e trupit gjykues për shkak të marrëdhënies së saj me shtetasin B. Zh., ndërkohë edhe dy anëtarët e tjera nuk kërkuan të tërhiqeshin për t’u shprehur me vendim mbi këtë kërkesë procedurale, çfarë i implikon edhe ato në mungesë paanësie dhe paragjykim të çështjes.

10.5.2. Kërkesat e mësipërme u morën në shqyrtim nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short (i njëjti trup gjykues për të dyja kërkesat), i cili me vendimin e datës 17.09.2021, rrëzoi kërkesën e subjektit për përjashtimin e komisioneres E. Ç. si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ndërsa me vendimin e datës 17.09.2021, rrëzoi kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të procesit të rivlerësimit. Në këtë të fundit, është arsyetuar se trajtimi i të dyja kërkesave prej

<sup>36</sup> Seanca dëgjimore në Komision është zhvilluar në datat 26.07.2021, 03.09.2021, 15.09.2021 dhe 22.09.2021.



këtij trupi gjykues ka qenë i kushtëzuar nga fakti i depozitimit në të njëjtën kohë të dy kërkesave për përjashtim. Në vendimet për rrëzimin e kërkesës për përjashtim, Komisioni ka arsyetuar:

**10.5.2.1.** Në vendimin për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e komisioneres E. Ç., është arsyetuar se përveç punësimit pranë shoqërisë “{\*\*\*}” të komisioneres, nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk u paraqit asnjë provë për ekzistencën e ndonjë marrëdhënie interesi private ndërmjet saj dhe z. B. Zh. apo ndikim i çfarëdolloj natyre i këtij të fundit mbi komisioneren.

**10.5.2.2.** Sa i takon rrëzimit të kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues, është arsyetuar se ushtrimi i detyrës funksionale apo mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit nuk përbën paragjykim dhe cenim të paanësisë së trupit gjykues të Komisionit e, për rrjedhojë, nuk mund të përbëjë shkak për përjashtimin e anëtarëve të tij, sipas ligjit nr. 84/0216 dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

**10.5.3.** Në linjë me Komisionin, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se 4 (katër) nga 5 (pesë) shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues lidhen me veprime procedurale të trupit gjykues, të cilat nuk parashikohen në asnjë nga rastet e përcaktuara nga neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkaqe anësie. Sa i takon shkakut të ngritur në këtë kërkesë që ka të bëjë me pretendimin se komisionerja E. Ç., në seancën dëgjimore të datës 15.09.2021, është shprehur mbi kërkesën e përjashtimit të saj, nga verifikimi i procesverbalit të kësaj seance, trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezulton që komisionerja E. Ç., në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, të ketë shprehur opinion lidhur me themelin e kërkesës për përjashtimin e saj, por është shprehur se çështja do t'i kalojë një tjetër trupi gjykues të caktuar me short. Sa i përket pretendimit të ngritur në kërkesën për përjashtimin e komisioneres E. Ç., trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vetëm fakti se komisionerja ka punuar më parë në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, pjesë e kompanisë “{\*\*\*}”, nuk mund të shërbejë si premisë për të konkluduar se ajo gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimit të nenit 30, shkronja “g” e Kodit të Procedurave Administrative. Përpos kësaj, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë fakt apo rrethanë që të provojë se komisionerja E. Ç. ka pasur një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë e, më pak akoma, të jetë ndikuar nga z. B. Zh..

**10.5.4.** Nga pikëpamja procedurale, trupi gjykues i Kolegjit vëren se dy kërkesat e paraqitura nga subjekti janë shqyrtuar sipas nenit 27, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 20, pika 1 e Rregullores “Mbi veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Shqyrtimi i të dyja kërkesave nga i njëjti trup gjykues i caktuar me short dhe i ndryshëm nga ai që ka shqyrtuar themelin e çështjes, në vlerësim të Kolegjit nuk përbën shkelje procedurale, për më tepër, në konsideratë të fakteve të tilla si: (i) paraqitja e kërkesave, në një moment procedural të procesit të rivlerësimit siç është seanca dëgjimore; (ii) shkaqet e përjashtimit përsëriten në të dyja kërkesat; (iii) shkaqet e përjashtimit që lidhen me veprime procedurale të trupit gjykues, krijohet bindja se qëllimi i subjektit të rivlerësimit ka qenë zvarritja e procesit të tij të rivlerësimit. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se pavarësisht kërkesave të shumta për përjashtim nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, në asnjë rast nuk ka lënë pa i shqyrtuar këto kërkesa nga trupa gjyquese të ndryshme të shortuara për këtë qëllim.



10.6. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i ndërmjetëm i datës 22.01.2020 "Për administrimin e dokumenteve nga dosja e subjektit të rivlerësimit R. G." është marrë në shkelje të rënda procedurale të neneve 45, 49, 50 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën<sup>37</sup> e Kolegjit. Në vijim të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit kundërshton edhe vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2020, të Komisionit, mbi të cilin bazohet vendimi i ndërmjetëm i datës 22.01.2020, si i pabazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 9 të Rregullores "Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", që kanë të bëjnë me organizimin e Komisionit dhe detyrat e Mbledhjes së Komisionit.


10.6.1. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se çështjet të cilat përbëjnë thelbin e tij renditen si në vijim: (i) sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka të drejtën e një hetimi të pavarur dhe vendimi duhet të jepej bazuar vetëm në provat që i përkisnin çështjes së tij dhe jo në provat mbi të cilat u shkarkua nga detyra bashkëshortja e subjektit R. G.; (ii) dokumentet që vërtetonin veprime, fakte, cilësi apo një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit të subjektit, duhet të merreshin sipas burimeve për kërkimin dhe marrjen e provave të parashikuara në nenet 49, 50 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) Komisioni, me administrimin e dosjes së subjektit të rivlerësimit R. G., ka paragjykuar të drejtën e subjektit për një hetim të pavarur, të paanshëm dhe objektiv; (iv) mund të merren parasysh dhe të administrohen provat e një çështjeje tjetër, vetëm nëse ajo çështje është pushuar dhe kur rimarrja rishtazi e provave paraqet vështirësi apo pengesa të pakapërcyeshme. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se:

10.6.2. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2020, Komisioni ka vendosur: (i) dhënien e aksesit në dosjet e arkivuara trupave gjykues që shqyrtojnë subjektet e rivlerësimit me lidhje familjare midis tyre; (ii) marrja dhe administrimi i dokumenteve nga dosja e arkivuar bëhet rast pas rasti me vendim të trupit gjykues; (iii) në çdo rast administrohen vetëm dokumente dhe prova që kanë lidhje me hetimin e kryer për subjektin e rivlerësimit.

10.6.3. Me vendimin e datës 22.01.2020, trupi gjykues i procesit të rivlerësimit, në zbatim të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2020, të Komisionit, ka vendosur administrimin e dokumenteve nga dosja e subjektit të rivlerësimit R. G., të cilat duhet t'i bashkëlidhen dosjes së hetimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Gina. Pas një kërkesë të datës 08.09.2020 të relatores së çështjes, përmes urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 08.09.2020, nga Kryetari i Komisionit është urdhëruar vendosja në dispozicion të relatores së dosjes gjyqësore të arkivuar të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 25.07.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit R. G., person i lidhur me z. Dritan Gina, subjekt në proces rivlerësimi.

10.6.4. Kolegji, pasi analizoi situatën faktike, në raport me parashikimet ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit dhe deklarinimin e pasurive ndër vite, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me administrimin e dosjes së bashkëshortes së tij znj. R. G., nuk janë të bazuara ligjërisht, për sa arsyetuar në vijim.

<sup>37</sup> Vendimi (JR) nr. 20, datë 31.07.2019, paragrafi 78 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që i përket subjektit të rivlerësimit G. O..



10.6.5. Në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, bashkëshortja e subjektit konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës i nënshtrohet vlerësimit të pasurive së bashku me subjektin e rivlerësimit, duke dorëzuar deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, pjesë e deklaratës *vetting*. Në rastin konkret, bashkëshortja e subjektit është njëkohësisht person i lidhur i ngarkuar me detyrim deklarimi për shkak të bashkëshortit të saj, por edhe për shkak të të qenit vetë subjekt rivlerësimi. Po ashtu, referuar neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, që me hyrjen në fuqi të tij, bashkëshortët e subjekteve deklarues plotësojnë deklaratën e interesave private të personave që mbartin detyrimin për deklarim, që i bashkëngjitet deklaratës së interesave private periodike të subjektit deklarues, të cilat në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të përdoren si prova. Në analizë të këtyre dispozitave kuptohet që administrimi dhe analizimi i deklarimeve të secilit bashkëshort është qartazi një veprim procedural normal në funksion të procesit të rivlerësimit. Këto dispozita, lexuar në harmoni me nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit Komisioni i vlerëson provat në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera duke i çmuar ato sipas bindjes së brendshme, nënkuptojnë se pavarësisht administrimit të të njëjtave prova, vendimmarrja e trupave gjykuese është e pavarur.

10.6.6. Fakti që dëshmon më së miri respektimin e të gjitha garancive për paanësinë dhe pavarësinë e Komisionit në procesin e rivlerësimit të subjektit Dritan Gina, është mënyra e krijimit të trupit të tij gjykues, deri në përbërjen përfundimtare të tij. Kolegjit i rezulton se procesi i rivlerësimit të subjektit Dritan Gina është kryer nga një trup gjykues i përzgjedhur me short, i ndryshëm nga trupi gjykues i procesit të rivlerësimit të znj. R. G.<sup>38</sup>, i shortuar më datë 12.11.2019. Në datën 19.11.2019, anëtari i trupit gjykues L. H. paraqiti kërkesën për dorëheqje nga rivlerësimi i subjektit argumentuar me faktin se ai kishte qenë relator në procesin e rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit, znj. R. G.. Kërkesa e tij u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short<sup>39</sup>, i cili në datën 21.11.2019 vendosi pranimin e saj. Në datën 03.12.2019, komisionerja G. T. (B.), në cilësinë e anëtares zëvendësuese pas pranimit të dorëheqjes së komisionerit L. H., paraqiti kërkesë për dorëheqje nga procesi i rivlerësimit të subjektit, argumentuar, gjithashtu, me faktin se kishte qenë anëtare e trupit gjykues të znj. R. G.. Kërkesa e saj u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues i caktuar me short<sup>40</sup>, i cili në datën 05.12.2019 vendosi<sup>41</sup> pranimin e saj. Pas pranimit të dorëheqjes së znj. T. (B.), në datën 06.12.2019 u caktua me short<sup>42</sup> për rivlerësimin si anëtare e trupit gjykues të rivlerësimit të subjektit, komisionerja E. Ç.. Me caktimin e saj, trupi gjykues përbëhej nga anëtarët V. S., Xh. P. dhe E. Ç., të cilat kanë plotësuar deklaratën mbi mungesën e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

<sup>38</sup> Referuar vendimit nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, trupi gjykues i procesit të rivlerësimit të znj. R. G. ka pasur përbërjen komisionerët G. T. (B.), L. H. dhe P. Q..

<sup>39</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2019, të Komisionit, u ngrit trupi gjykues i përbërë nga komisionerët S. Zh., O. K. dhe B. B., i cili me vendimin e datës 21.11.2019 vendosi pranimin e dorëheqjes së komisionerit L. H.

<sup>40</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 04.12.2019, për ngritjen e trupit gjykues (E. Ç., F. Sh., A. F.).

<sup>41</sup> Vendim i datës 05.12.2019, për pranimin e dorëheqjes së komisionere G. T..

<sup>42</sup> Vendim nr. {\*\*\*}, datë 06.12.2019, për caktimin me short të anëtares E. Ç. në trupin gjykues të subjektit.



10.6.7. Administrimi i dosjes së bashkëshortit/bashkëshortes, siç rezulton nga vendimi nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2020, i Komisionit, është një veprim procedural i aplikuar nga Komisioni në çdo rast mes dy subjekteve rivlerësimi bashkëshortë me njëri-tjetrin. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se një vendimmarrje e tillë ka ardhur edhe për shkak të nevojës së një hetimi të gjerë pas refuzimit nga ana e subjektit të rivlerësimit për t'u përgjigjur pyetësorit standard të Komisionit<sup>43</sup>. Me mosveprimin e tij në këtë rast, subjekti i rivlerësimit e ka orientuar këtë të fundit drejt përdorimit të dokumentacionit të depozituar prej tij së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, i cili është i njëjti me dokumentacionin e dorëzuar nga bashkëshortja e tij në funksion të procesit të saj të rivlerësimit, për shkak të pasurive të përbashkëta mes tyre. Lidhur me vendimin (JR) nr. 20, datë 31.07.2019, të Kolegjit, sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Kolegji në këtë rast nuk e mbështet pretendimin e subjektit të rivlerësimit se administrimi i dosjes së bashkëshortes, si subjekt i shkarkuar, e paragjykon çështjen e tij, përkundrazi, qëndrimi i mbajtur nga Kolegji përmes këtij vendimi, por edhe në vendimin (JR) nr. 17, datë 27.05.2022<sup>44</sup>, përbëjnë garanci për subjektet e rivlerësimit, bashkëshortë me njëri-tjetrin, se vendimi i dhënë për njërin bashkëshort nuk afekton drejtësinë dhe objektivitetin për bashkëshortin tjetër, dhe se të dy kanë të drejtën t'i nënshtrohen një procesi rivlerësimi të pandikuar nga procesi i bashkëshortit tjetër. Ndërsa sa i takon pretendimit mbi bazueshmërinë ligjore të vendimi nr. {\*\*\*}, datë 08.01.2020, të Komisionit, mbi të cilin bazohet vendimi i ndërmjetëm i trupit gjykues, të adresuar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nxjerrja e një akti të tillë nga ana e Komisionit është brenda kompetencës së tij për të miratuar akte nënligjore në zbatim të ligjit nr. 84/2016 e përcaktuar konkretisht në nenin 9 të Rregullores "Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit". Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky akt është miratuar nga Mbledhja e Komisionit në kuadër të juridiksionit të tij administrativ dhe, si i tillë, vlerësohet se del jashtë tagrit të kontrollit të Kolegjit, i cili kontrollon vetëm aktet e trupave gjykues në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit.

10.6.8. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka kryer një proces hetimi në përputhje me nenet 45 - 50 të ligjit nr. 84/2016, si dhe duke respektuar parimin e procesit të rregullt ligjor, paanësisë dhe kontradiktoritetit, sipas rrethanave specifike dhe objektive të çështjes, çka dëshmohet nga të gjitha veprimet e Komisionit përgjatë gjithë procesit të rivlerësimit të subjektit. Në analizë të situatës faktike, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në funksion të hetimit administrativ janë ndërmarrë veprimet e hetimit administrativ, subjekti është njoftuar mbi përfundimin e hetimit administrativ dhe rezultatet e këtij hetimi, duke i caktuar një kohë të mjaftueshme për

<sup>43</sup> Shkresë përgjigje e subjektit të rivlerësimit e datës 05.05.2020.

<sup>44</sup> Në paragrafët 20.1 dhe 20.6 të këtij vendimi, Kolegji shprehet se [...] vlen të theksohet se secili subjekt rivlerësimi duhet të rivlerësohet në mënyrë të pavarur jo vetëm në kriteret e figurës dhe aftësisë profesionale, të cilat janë thellësisht individuale, por edhe në kriterin e pasurisë, si një kriter që përfshin edhe persona të tjerë në marrëdhënie pronësie, persona të lidhur apo të tjerë të lidhur qofshin ata dhe Kolegji vlerëson se, si në rastin konkret, qenia e dy subjekteve të rivlerësimit njëkohësisht edhe bashkëshortë, si dhe pasja e pasurive të përbashkëta në objekt të shqyrtimit në proceset e tyre të rivlerësimit, nuk afekton procesin e bashkëshortit që rivlerësohet i dyti në kohë dhe nuk përbën gjë të gjykuar edhe pse kanë pasuri të përbashkëta, pasi subjektet e rivlerësimit që janë subjekt i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kanë të drejtën e një procesi rivlerësimi të pavarur, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së tyre dhe konsiderohen procese me palë të ndryshme e, për rrjedhojë, nuk përbëjnë gjë të gjykuar.





të dhënë shpjegime mbi çështjet për të cilat i kishte kaluar barra e provës dhe duke i garantuar të drejtën për t'u njohur me dosjen. Në përgjigje të këtyre rezultateve, në datën 12.07.2021, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova mbështetëse për to. Po kështu, në respektim të parimit të kontradiktoritetit, subjektit të rivlerësimit i është krijuar mundësia për t'u dëgjuar dhe debatuar mbi rezultatet e hetimit të Komisionit në seancën dëgjimore të mbajtur në datat 26.07.2021, 03.09.2021 dhe 15.09.2021. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën për t'u përfaqësuar nga një përfaqësues ligjor i caktuar prej tij. Komisioni ka shqyrtuar përmes trupave gjykues të caktuara me short 5 (pesë) kërkesa për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues të procesit të rivlerësimit. Komisioni, për të garantuar një proces të rregullt ligjor, ka pranuar disa herë kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht: -- ka shtyrë seancën dëgjimore të parashikuar për t'u mbajtur në datën 16.07.2021, për shkak të paafësisë së përkohshme në punë të subjektit të rivlerësimit; -- ka shtyrë seancën dëgjimore të datës 26.07.2021, me qëllim për t'i dhënë kohë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur me shkrim kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues; si dhe -- ka shtyrë seancën dëgjimore të datës 03.09.2021, për shkak të paafësisë së përkohshme në punë të përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit, z. E. B.. Të gjitha këto veprime të Komisionit dëshmojnë se subjektit të rivlerësimit i është garantuar një proces i rregullt ligjor dhe pa asnjë paragjykim.

**10.6.9.** Trupi gjykues i Kolegjit, për sa arsyetuar më sipër, e gjen të drejtë vendimin e datës 22.01.2020, të Komisionit, për administrimin e dosjes së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. R. G..

**10.7.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se i është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e garantuar nga neni 6, pika 1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNJ"), neni 42, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe jurisprudenca<sup>45</sup> e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese<sup>46</sup>, pasi anëtarja e trupës gjykuese, komisionere V. S., ka mangësi të theksuara të formimit profesional, sipas nenit 6, pika 1, shkronjat "b" dhe "c" të ligjit nr. 84/2016, ndërsa anëtarja E. Ç. nuk përmbush kushtet ligjore të kërkuara nga neni 6, pika 1, shkronjat "b", "c" dhe "d" të ligjit nr. 84/2016, pasi ndaj saj ka nisur një hetim penal për deklarim të rremë të pasurisë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur: (i) një artikull të datës 31.05.2021, të botuar në portalin *in-front.org*, që denoncon problemet e pamjaftueshmërisë profesionale të komisioneres V. S.; (ii) një artikulli të datës 18.02.2021, të botuar në të njëjtin portal, që denoncon deklaratimet e rreme të pasurisë dhe burimet e paligjshme financiare të komisioneres E. Ç.; si dhe (iii) një kallëzim penal në SPAK, të Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion ndaj komisioneres E. Ç..

**10.7.1.** Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimeve, lidhur mosplotësimin e kritereve ligjore të parashikuara nga neni 6, pika 1, shkronjat "b", "c"

<sup>45</sup> Çështja "Gudmundur Andri Astradsson kundër Islandës" 2020; çështja "Lavents kundër Latvia" 2002; çështja "Gorguildaze kundër Gjeorgjisë" 2009; çështja "Kontalexis kundër Greqisë" 2011; çështja "Sokurenko dhe Strygun kundër Ukrainës" 2006; çështja "Richert kundër Polonisë" 2011; çështja "Ezgeta kundër Kroacisë" 2017; çështja "Llatovski kundër Rusisë"; çështja "Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë" 2011.

<sup>46</sup> Vendimet nr. 20, datë 09.07.2009; nr. 2, datë 29.01.2016; nr. 69, datë 17.11.2015 dhe nr. 15, datë 11.03.2021.



dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, për të qenë komisioner i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, iu është dhënë përgjigje tashmë nga jurisprudenca<sup>47</sup> e tij, duke i vlerësuar ato si pretendime të pabazuara për vetë natyrën *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe strukturën kushtetuese të institucioneve të këtij procesi. Në këtë drejtim, dispozitat kushtetuese dhe ligjore kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, institucionet e ngarkuara në çdo hap të këtij procesi përzgjedhës, deri në emërimin përfundimtar të tyre nga Kuvendi i Shqipërisë. Në lidhje me anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, Kolegji ka kompetencë vetëm për të hetuar dhe gjykuar shkeljet disiplinore të tyre, të kryera gjatë ushtrimit të detyrës dhe për të cilat mund të vihet në lëvizje vetëm sipas parashikimeve të nenit 17, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për artikujt e botuar në portalin *in-front.org* në datat 31.05.2021 dhe 18.02.2021, si dhe kallëzimi penal i Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion, lidhur me komisioneren E. Ç., të cilat subjekti i rivlerësimit i citon në ankim në cilësinë e provave të reja në proces, trupi gjykues konstaton se ato u përkasin burimeve të hapura, të publikuara në platforma të ndryshme elektronike dhe lehtësisht të aksesueshme nga trupi gjykues duke gëzuar statusin e fakteve të njohura nga Kolegji, në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht këtij argumenti, ato u konsideruan prej trupit gjykues të Kolegjit si të panevojshme, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

**10.8.** Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit përfundimtar, pasi nuk ka arritur një konkluzion për kriterin e kontrollit figurës, edhe pse e kishte hetuar dhe i kishte kaluar barrën e provës subjektivit të rivlerësimit edhe për këtë kriter. Për të mbështetur pretendimin e tij, subjekti i rivlerësimit referon në vendimin nr. 14, datë 15.06.2021 (JR), të Kolegjit, sipas së cilit *Komisioni ka për detyrë të konkludojë në themel në lidhje me vlerësimin e të tria kriterëve të procesit të rivlerësimit.*

**10.8.1.** Në analizë të këtij shkak ankimi, referuar përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, në raport me përcaktimet e nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se vendimi i Komisionit në tërësinë e tij përmban përshkrimin e rrethanave të çështjes, provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara nga Komisioni gjatë procesit të hetimit administrativ, analizën e tyre, si dhe përfundimet e arritura lidhur me to, duke arritur në konkluzionin se: *“Në vijim të përfundimeve të arritura, trupi gjykues çmon se konkluzionet, lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting dhe konkluzionet lidhur me vlerësimin e qëndrimit të subjektivit mbi procesin, janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar, vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, si dhe nuk ka qenë bashkëpunues në këtë proces si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra”.* Ndërsa në rubrikën “Kontrolli i Figurës”, vendimi i Komisionit nis me përshkrimin e rrethanave të çështjes mbi hetimin e kryer për këtë kriter, provat e administruara, vijon me qëndrimin e subjektivit të rivlerësimit dhe, në përfundim, Komisioni shprehet se: *“[...] trupi gjykues e çmoi të panevojshëm arritjen e një konkluzioni lidhur me komponentin e figurës për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me të nuk do të arrinte të ndryshonte*

<sup>47</sup> Vendimet nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023; nr. 8/2022 (JR), datë 07.04.2022; nr. 35/2022 (JR), datë 22.09.2022.



vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra”. Në vlerësimin e trupit gjykues, Komisioni duhet të kishte arritur një konkluzion edhe mbi kriterin e kontrollit të figurës, por ky fakt nuk cenon *apriori* standardin e arsyetimit ligjor në vendimin e dhënë, për sa kohë Komisioni ka arsyetuar mbi provat në të cilat është bazuar vendimmarrja për shkarkimin e tij.

10.9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i ndërmjetëm mbi refuzimin e kërkesës së subjektit për t’u pajisur me kopje të Raportit të Aftësive Profesionale, i njoftuar subjektit përmes *e-mail*-it të datës 23.07.2021, është marrë në shkelje të rënda të normave procedurale, e është i paarsyetuar edhe në vendimin përfundimtar pasi: (i) gjykata nuk është shprehur në mënyrë të prerë dhe përfundimtare në lidhje me këtë kërkesë procedurale, duke përdorur shprehjen “*deri në këtë moment të hetimit*”; (ii) gjykata nuk mund të zhveshë veten, nga detyrimi ligjor për të treguar arsytet e vendimmarrjes së saj, qoftë edhe për një vendim të ndërmjetëm, aq më tepër kur ky vendim rrëzon kërkesën procedurale të subjektit; (iii) subjekti ka të drejtë të njihet dhe të marrë kopje të të gjitha akteve dhe dokumenteve të dosjes së rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe përcaktimeve të nenit 45 të Kodit të Procedurave Administrative. Fakti që hetimi është mbyllur vetëm për kriteret e pasurisë dhe të kontrollit të figurës, nuk përbën shkak ligjor për t’i kufizuar të drejtën ligjore për t’u njohur me dokumentet e dosjes, ndërkohë që rezulton që subjekteve të tjera të rivlerësimit, i është vënë në dispozicion ky raport, pavarësisht nga fakti që nuk ishin hetuar për kriterin e aftësive profesionale. Nga analizimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se:

10.9.1. Më datë 28.06.2021, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit administrativ për kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollin e figurës, duke i garantuar të drejta për njohjen me dosjen e hetimit administrativ, sipas nenit 45 të Kodit të Procedurave Administrative, për të cilën subjekti i rivlerësimit më datë 07.07.2021, ka nënshkruar deklaratën, me anë të së cilës konfirmon njohjen dhe marrjen e gjithë dokumentacionit, sipas kërkesës së tij, pa pasur asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr.

10.9.2. Me kërkesën e datës 21.07.2021, subjekti ka kërkuar të marrë kopjen e vulosur të raportit të aftësive profesionale të miratuar nga KLP-ja, argumentuar me faktin se në dokumentin “*Rezultate hetimi për subjektin e rivlerësimit Dritan Gina*”, në faqen e tij të parë, është shënuar se rezultati është bazuar, ndër të tjera, edhe në këtë raport. Nga verifikimi i dokumentit “*Rezultate hetimi për subjektin e rivlerësimit Dritan Gina*”, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në hyrje të tij, si një ndër dokumentet/provat ku bazohet rezultati i hetimit referohet edhe Raporti i Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale (miratuar nga KLP-ja), ndërkohë që nga përmbajtja e këtij dokumenti, qoftë në pjesën e përshkrimit të fakteve, qoftë në atë arsyetuese, është lehtësisht e dallueshme se hetimi ka përfunduar për dy kritere atë të pasurisë dhe të figurës e, në këtë pikëpamje, referimi në pjesën hyrëse të këtij dokumenti se rezultatet e hetimit janë bazuar edhe në raportin e aftësive profesionale, duket se është një gabim material, pa ndonjë pasojë në vendimin e Komisionit.

10.9.3. Në përgjigje të kërkesës së subjektit për marrjen e këtij raporti, Komisioni më datë 23.07.2021 ka njoftuar subjektin përmes postës elektronike (*e-mail*) se [...] *deri në këtë moment të hetimit administrativ nuk pranon kërkesën tuaj për vendosje në dispozicion të raportit të*



*aftësive profesionale. Trupi gjykues rezervon të drejtën e arsytimit të këtij vendimi të ndërmjetëm me vendimin përfundimtar.* Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se neni 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 përcakton detyrimin e Komisionit për t'i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për çështjet për të cilat provat kanë pasur nivelin e provueshmërisë dhe është detyrë e subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën për gjetjet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ. Në kuptim të kësaj norme, deri në atë moment procedural, Komisioni i ka dhënë subjektit aksesin në dosjen e hetimit për dy kriteret, të vlerësimit të pasurisë dhe kontrollin e figurës, duke nënkuptuar që dosja e aftësive profesionale do të ishte e aksesueshme në varësi të mbrojtjes së tij për të kundërshtuar barrën e provës për dy kriteret e para. Nëse në atë moment procedural Komisioni nuk do të kishte përdorur shprehjen *deri në këtë moment*, ky fakt po që do të përbënte paragjykim të çështjes, që në kuptim të nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i zhvillon bisedimet për marrjen e vendimit pas seancës dëgjimore, pasi ka dëgjuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit. Sa i takon mungesës së arsytimit mbi refuzimin e kësaj kërkesë, në kushtet kur subjekti ka qenë i qartë mbi arsyet e refuzimit e në kushtet kur vendimmarrja e Komisionit është bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në provat e administruara për këtë kriter, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi ligjshmërinë e këtij vendimi është i pabazuar.

**10.10.** Subjekti pretendon se vendimi i ndërmjetëm i Komisionit i datës 14.07.2021 për refuzimin e kërkesës për riçeljen dhe vazhdimin e hetimit për kriterin e aftësive profesionale, me arsytimin se provat për kriteret e pasurisë dhe të figurës kanë arritur nivelin e provueshmërisë, duke u bazuar në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, referencë ligjore që mund të përdoret për të justifikuar vendimmarrjen përfundimtare në rast shkarkimi nga detyra, e bën *nul* procedurën e gjyqimit dhe vendimin përfundimtar ndaj subjektit të rivlerësimit.

**10.10.1.** Në analizë të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendimin për refuzimin e kësaj kërkesë, është shprehur [...] *të mos riçelë hetimin administrativ për kriterin e aftësive profesionale deri në këtë fazë të hetimit, kjo pasi provat për këto dy kritere kanë arritur nivelin e provueshmërisë bazuar në pikën 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.* Trupi gjykues i Kolegjit vëren mospërputhje mes arsytimit dhe dispozitës ligjore të përdorur për të legjitimuar këtë arsyetim. Parashikimi ligjor *provat për këto dy kritere kanë arritur nivelin e provueshmërisë*, i përket nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me barrën e provës, që korrespondon edhe me fazën në të cilën ndodhej procesi deri në atë moment, kur subjektit më datë 28.6.2021 i kishte kaluar barra e provës dhe i ishin bërë të njohura çështjet për të cilat provat kishin nivelin e provueshmërisë. Në varësi të faktit, nëse shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit do të mund të përmbysnin konkluzionet paraprake të Komisionit lidhur me këtë kriter, do të bëhej dhe vlerësimi i Komisionit mbi çeljen ose jo të hetimit për kriteret e tjera. Ndërkohë neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 i referohet momentit fundor të procesit të rivlerësimit, atij të vendimmarrjes. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo shprehje e Komisionit përbën një lapsus apo një gabim material që nuk cenon ligjshmërinë e vendimit të dhënë.

**10.11.** Subjekti pretendon se hetimi vetëm për dy kritere rivlerësimi dhe vendimmarrja vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë i pamundëson atij të drejtën e një ankimi efektiv në Kolegji. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit i referohet vendimit nr. 14/2021 (JR)



datë 15.06.2021, të Kolegjit, sipas së cilit subjekti nuk mund të konfirmohet në detyrë nga Kolegji, nëse Komisioni në vendimin e tij nuk ka konkluduar lidhur me vlerësimin e të tria kritereve.


10.11.1. Këtij shkakut ankimor, Kolegji i ka dhënë përgjigje në qëndrimin e konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën e tij<sup>48</sup>. Neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 përcakton qartazi se procesi i rivlerësimit jo domosdoshmërisht fillon dhe përfundon me shqyrtimin e të tria kritereve të procesit të rivlerësimit. Kjo dispozitë lexuar në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, që për konfirmimin në detyrë të një subjekti kërkon vlerësim pozitiv e besueshmëri për të tria kriteret së bashku, lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit edhe mbështetur në një ose dy kritere, për ekonomi gjyqësore në ato raste, kur subjekti i rivlerësimit nuk arrin një nivel të besueshëm në një kriter, duke pamundësuar kështu konfirmimin e tij në detyrë. Ndërkaq vendimi nr. 14 (JR), datë 15.06.2021, i Kolegjit<sup>49</sup>, në vlerësim të trupit gjykues, jo vetëm nuk e mbështet pretendimin e subjektit të rivlerësimit, por përkundrazi dëshmon më së miri, mundësinë e një ankimi efektiv përpara Kolegjit, pasi edhe pse Komisioni kishte disponuar me shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pas kontrollit nga ana e Kolegjit të kësaj vendimmarrje, vënë në lëvizje përmes ankimit të subjektit të rivlerësimit, Kolegji disponoi me prishjen e vendimit duke urdhëruar Komisionin të vazhdojë procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

10.12. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka shqyrtuar dhe nuk është shprehur me vendim të ndërmjetëm dhe as në vendimin përfundimtar në lidhje me kërkesën procedurale të subjektit të rivlerësimit të datës 21.09.2021 “Për riçelje të hetimit në lidhje me kriterin e profesionalizmit”, duke i cenuar atij të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën për ta ankimuar këtë vendimmarrje.

10.12.1. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, nga aktet në dosjen gjyqësore, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në datën 21.09.2021, një ditë përpara seancës së shpalljes së vendimit, subjekti i ka dërguar trupit gjykues një e-mail me objekt “Kërkesë për riçelje të hetimit për kriterin e profesionalizmit, së bashku me provat”, e njëjtë me atë të datës 12.07.2021, kërkesë e refuzuar nga Komisioni me arsyetimin se deri në këtë fazë të hetimit, provat për dy kriteret e tjera kishin arritur nivelin e provueshmërisë. Për subjektin tashmë ishte e qartë se hapja ose e jo e hetimit për vlerësimin e aftësive profesionale do të varej nga vlerësimi përfundimtar që Komisioni do të bënte lidhur me provat e sjella prej tij për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës dhe nga fakti nëse provat do të mund të përmbysnin konkluzionet paraprake të Komisionit, lidhur me këto kritere. Një gjë e tillë mund të ndodhte vetëm pas bisedimeve për marrjen e vendimit, sipas nenit 55, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Një kërkesë e tillë e përsëritur e paraqitur në fazën përfundimtare të mbylljes së procesit, një ditë përpara shpalljes së vendimit

<sup>48</sup> Vendimet nr. 3/2018 (JR), datë 17.07.2018; nr. 1/2019 (JR), datë 31.01.2019; nr. 3/2019 (JR), datë 07.02.2019; nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; nr. 12/2018 (JR), datë 29.05.2019; nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; nr. 28/2019 (JR), datë 24.10.2019; nr. 24/2021 (JR), datë 28.07.2021; nr. 9, datë 11.04.2022; dhe nr. 37/2022 (JR), datë 11.10.2022.

<sup>49</sup> Vendimi (JR) nr. 14, datë 15.06.2021.



përfundimtar, për të cilën subjekti kishte marrë një përgjigje, nga trupi gjykues vlerësohet si një përpjekje për zvarritjen e procesit dhe nuk i ka cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

10.13. Subjekti i rivlerësimit pretendon se moszhvillimi i formalitetit të tërheqjes së trupit gjykues në dhomë këshillimi për bisedimin e çështjes, përpara shpalljes së vendimit përfundimtar është shkelje shumë e rëndë procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit përfundimtar. Sipas tij, trupi gjykues vendosi të ndërpresë seancën dëgjimore të datës 15.09.2021 në prani të tij, për ta vijuar atë përsëri në datën 22.09.2021, ndërkohë që në datën 22.09.2021 shpalli vendimin përfundimtar.

10.13.1. Në përgjigje të këtij pretendimi, nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 15.09.2021, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në përfundim të seancës kryesuesja e trupit gjykues ka deklaruar ndërprerjen e saj duke njoftuar rifillimin të seancës në datën 22.09.2021. Procedurën e ndjekur nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit e gjen në përputhje me nenin 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se *vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore*. Në këtë kuptim, ndërprerja e seancës dëgjimore nuk nënkupton përfundimin e saj, pasi kjo seancë konsiderohet e përfunduar më datë 22.09.2021, kur është shpallur vendimi i Komisionit. Mënyra se si Komisioni ka administruar seancën dëgjimore vjen në përputhje me parashikimin ligjor, sipas së cilit seanca dëgjimore konsiderohet e mbyllur me shpalljen e vendimit përfundimtar.

10.14. Subjekti pretendon se seanca dëgjimore e datës 22.09.2021 dhe shpallja e vendimit përfundimtar janë bërë në shkelje të rënda procedurale, pa u respektuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me gjykimin dhe shpalljen e vendimit në mungesë të subjektit, e cila zhvillohet vetëm në rastin kur ai nuk është paraqitur personalisht, ndonëse është njoftuar rregullisht dhe nuk ka paraqitur shkaqe të justifikuara për mungesën e tij. Ai pretendon se për shkak të mungesës së kartës së identitetit i është ndaluar hyrja në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore. Me nisjen e seancës ai ka tentuar hyjë në sallë, por është ndaluar dhe është larguar nga Shërbimi i Gardës, pa një urdhër të trupit gjykues për të ndërmarrë këtë veprim.

10.14.1. Në analizë të këtyre pretendimeve, referuar procesverbaleve të seancës dëgjimore, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë i pranishëm përgjatë gjithë seancës dëgjimore të zhvilluar në datat 26.07.2021, 03.09.2021 dhe 15.09.2021, duke iu dhënë e gjitha koha e mjaftueshme për t'u dëgjuar, debatuar dhe përgjigjur pyetjeve të trupit gjykues. Nga përmbajtja e procesverbalit të datës 15.09.2021, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në përfundim të saj, në prani të subjektit të rivlerësimit është njoftuar ndërprerja dhe rifillimi i saj në datën 22.09.2021, në orën 9:00. Në këto kushte, vlerësohet i pavend pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai është gjykuar në mungesë. Nga verifikimi i regjistrimit audio të seancës dëgjimore të datës 22.09.2021, lidhur me rrethanën e pretenduar nga subjekti, vihet re se Komisioni, pas konstatimit të mungesës së pranisë së subjektit në këtë seancë, e vijoi atë duke u shprehur mbi kërkesën e subjektit për përjashtimin e trupit gjykues të paraqitur në seancën e mëparshme. Pas këtij momenti, nga ana e kryesueses së trupit gjykues është konstatuar fakti që [...] subjekti i rivlerësimit u fut me forcë në sallën e seancave dëgjimore, pasi sipas njoftimit nga koordinatori për mediat nuk ka pranuar të kontrollohet nga Garda e Republikës në hyrje të sallës së seancës dëgjimore. Në kushtet kur subjekti është njoftuar rregullisht dhe ka qenë i



informuar mbi datën dhe orarin e vijimit të seancës dëgjimore, ka ushtruar të drejtën e tij për t'u dëgjuar përpara shpalljes së vendimit përfundimtar sipas nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative dhe është ezauruar i gjithë debati mbi çështjen, që sikurse është konstatuar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në përfundim të seancës së datës 15.09.2021 kishte zgjatur tej çdo pritshmërie, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni ka proceduar në mënyrë të rregullt me shpalljen e vendimit.

**10.15.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se konsiderimi i kërkesave procedurale të subjektit të rivlerësimit si mungesë bashkëpunimi dhe përpjekje për zvarritjen e gjykimit është shkelje e rëndë procedurale. Një qëndrim i tillë i Komisionit përbën cenim të së drejtës për t'u dëgjuar, për t'u mbrojtur efektivisht, për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, duke rënduar padrejtësisht pozitën e tij në raport me vendimmarrjen përfundimtare, e cila nuk duhet të lidhet me qëndrime subjektive të Komisionit.

**10.15.1.** Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se në paragrafin 9 të vendimit Komisioni shprehet se *z. Dritan Gina nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur në konsideratë kërkesat procedurale të shumta dhe të përsëritura, për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues duke synuar zvarritjen e procesit, në kushtet kur Komisioni i ka garantuar të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor – madje duke i dhënë kohë të mjaftueshme shtesë për të paraqitur provat dhe shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ.* Qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, mbi bashkëpunimin e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të hetimit, buron nga neni 48 i ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit Komisioni në marrjen e vendimit përfundimtar mban parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit. Nga kjo pikëpamje, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se Komisioni ka vepruar brenda tagrave të caktuar nga ligji dhe pretendimi i subjektit për shkelje procedurale të kryer nga trupi gjykues është i pabazuar.

**10.15.2.** Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për subjektivizëm në qëndrimin e Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 5 (pesë) kërkesa përjashtimi, si vijojnë: (i) kërkesë për përjashtimin e komisioneres V. S., në datën 04.05.2020; (ii) kërkesë për përjashtimin e komisionereve Xh. P. dhe E. Ç., në datën 04.05.2020; (iii) kërkesë për përjashtim të trupit gjykues të Komisionit, gjatë seancës dëgjimore të datës 26.07.2021; (iv) kërkesë për përjashtimin e komisioneres E. Ç. gjatë seancës dëgjimore të datës 15.09.2021; (v) kërkesë për përjashtimin e trupit gjykues gjatë seancës dëgjimore të datës 15.09.2021. Dy kërkesat e para janë paraqitur nga subjekti me marrjen dijeni të trupës gjykuese të procesit të rivlerësimit, kërkesa të cilat përmbajnë të njëjtat shkaqe përjashtimi që konsistojnë në kryerjen e veprimeve procedurale dhe në faktin e qenies së këtyre komisionereve në trupa gjykues që kanë trajtuar kërkesa procedurale të bashkëshortes së subjektit, znj. R. G., si sipërtrajtuar në këtë vendim. Mungesën e shqyrtimit të kërkesës për përjashtimin e dy komisionereve Xh. P. dhe E. Ç. të datës 04.05.2020, subjekti i rivlerësimit ia bëri prezent Komisionit 1 vit e 3 muaj më pas, në seancën dëgjimore të datës 26.07.2021, duke e përdorur si shkak për të paraqitur një tjetër kërkesë përjashtimi, kësaj here adresuar të gjithë trupit gjykues. Ndërsa dy kërkesat e tjera rezultojnë të jenë paraqitur, në momentin përfundimtar të procesit të rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 15.09.2021.



10.15.3. Në vijim të analizimit të këtij pretendimi, përkundër kësaj sjelljeje të subjektit, nga trupi gjykues i Kolegjit vihet re se Komisioni ka shqyrtuar të gjitha kërkesat për përjashtim të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit përpara vlerësimit përfundimtar të çështjes, i ka garantuar atij paraqitjen me shkrim të kërkesave të paraqitura në seancë dëgjimore, sipas nenit 27, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka pranuar të gjitha kërkesat e subjektit të rivlerësimit për shtyrje të seancës dëgjimore<sup>50</sup>. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton asnjë sjellje apo qëndrim paragjykes të Komisionit përgjatë veprimtarisë procedurale të hetimit administrativ.

10.16. Konkluzioni i Komisionit në paragrafët 9.1 dhe 9.2 të vendimit nr. 449, datë 22.09.2021, se [...] sjellja e subjektit në datën 22.09.2021, ku ka tentuar të hyjë me forcë në sallën ku zhvillohej seancë dëgjimore, është një sjellje që cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet ndonjë programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës, është një interpretim i gabuar dhe vjen në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, pasi programet e trajnimit në Shkollën e Magjistraturës aplikohen nga Komisioni në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në një kohë që në vendim Komisioni nuk ka konkluduar lidhur me këtë kriter. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky konstatim lidhet me garantimin e rregullit e të qetësisë në seancë, por nuk përbën arsye ligjore për të bazuar vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit.

10.16.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se rrethanat e tilla, si ajo e mosparaqitjes së kartës së identitetit, moslejimi i kontrollit nga Shërbimi i Gardës së Republikës dhe hyrja forcërisht në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore, janë konsideruar me të drejtë nga Komisioni si mungesë bashkëpunimi, që cenon besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke e kualifikuar këtë situatë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sikurse arsyetohet më gjerësisht në paragrafin 28 e vijues të këtij vendimi. Pavarësisht se në paragrafët e cituar nga subjekti, referohet programi i trajnimit në Shkollën e Magjistraturës që duket sikur lidhet me ndonjë vendimmarrje në vlerësim të aftësive profesionale, trupi gjykues edhe pse konstaton që Komisioni i ka qëndruar strikt dispozitës ligjore, duke përfshirë dhe plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, Kolegji tashmë ka një jurisprudencë<sup>51</sup> të konsoliduar lidhur me zbatueshmërinë e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë kjo që e gjen veten të zbatueshme edhe në rastet kur vendimmarrja nuk ka përfshirë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

10.17. Subjekti i rivlerësimit në ankim pretendon se as vendimmarrja e Komisionit e datës

<sup>50</sup> (i) Komisioni ka shtyrë seancën dëgjimore të planifikuar për t'u zhvilluar në datën 16.07.2021 për në datën 26.07.2021, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, që kishte çuar në paafësi të përkohshme në punë; (ii) në seancën e kësaj date, subjekti i rivlerësimit kërkoi përjashtimin e trupit gjykues, i cili, për t'i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit për ta paraqitur me shkrim kërkesën e tij, vendosi që seanca dëgjimore të shtyhej dhe të vijojë në datën 03.09.2021; (iii) në seancën e datës 03.09.2021, subjekti i rivlerësimit, me qëllim për t'iu garantuar e drejta e mbrojtjes efektive dhe përfaqësimit me avokat, për shkak të paafësisë së përkohshme në punë të avokatit të tij deri në datën 10.09.2021, kërkoi shtyrjen e saj. Kjo kërkesë e subjektit u pranua dhe seanca e radhës u caktua në datën 15.09.2021, ora 13:00; (iv) Komisioni i dha kohë subjektit të rivlerësimit për paraqitjen me shkrim të dy kërkesave të paraqitura në seancën dëgjimore të datës 15.09.2021.

<sup>51</sup> Vendimet nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023 dhe nr. 19/2023 (JR), datë 26.04.2023.





22.09.2021 dhe as vendimi i arsyetuar me shkrim nuk i janë përcjellë në kohën dhe në mënyrën e parashikuar nga ligji në adresën e tij zyrtare elektronike, e cila ka qenë aktive dhe funksionale. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2021 dhe akte të tjera shoqëruese, të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, përmes së cilës ai kërkon të provojë faktin se *e-mail*-i i tij zyrtar ka qenë aktiv dhe funksional gjatë gjithë kohës dhe se nga ana e Komisionit nuk i është komunikuar as vendimmarrja e trupës gjyquese të datës 22.09.2021 dhe as vendimi i arsyetuar me shkrim.

10.17.1. Në analizë të këtij shkakut ankimi, trupi gjyqësor i Kolegjit, nga aktet procedurale të Komisionit, konstaton se seanca dëgjimore në Komision është zhvilluar në datat 26.07.2021, 03.09.2021, 15.09.2021 dhe 22.09.2021 dhe subjekti i rivlerësimit ka qenë i pranishëm për gjatë saj, përveç momentit të shpalljes së vendimit, i cili është shpallur në datën 22.09.2021. Trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se ligji nr. 84/2016, në nenin 55, pika 7, përcakton se vendimi me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Në rastin konkret, vonesa me 5 ditë në arsyetimin e vendimit vlerësohet jo relevante në kushtet kur në zbatim nenit 63, pika 1 e po këtij ligji, subjektit të rivlerësimit i nis e drejta e ankimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Sa i takon njoftimit mbi vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit të datës 22.09.2021, neni 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 përcakton vetëm njoftimin e vendimit me shkrim, ndërsa njoftimi në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë një detyrim për Komisionin në këtë moment procedural, kur procesi i rivlerësimit ka përfunduar, pasi, sipas nenit 46, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, komunikimet me subjektin përmes postës elektronike janë detyrim i Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit. Në vijim të këtij arsyetimi, edhe shkresa kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2021, së bashku me aktet shoqëruese, të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme, përmes së cilës subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë faktin se *e-mail*-i i tij zyrtar ka qenë aktiv dhe funksional gjatë gjithë kohës dhe se nga ana e Komisionit nuk i është komunikuar as vendimmarrja e trupës gjyquese të datës 22.09.2021 dhe as vendimi i arsyetuar me shkrim, edhe nëse do të plotësonin kriteret formale të pranueshmërisë së përcaktuara në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012, nga trupi gjyqësor i Kolegjit vlerësohet si provë e panevojshme, për arsye se fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen dhe, si e tillë, duhet të refuzohet bazuar në parashikimin e nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

10.18. Çështjet që kanë të bëjnë me saktësinë e deklaratimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit, burimin e ligjshëm, mënyrën e përfitimit, pagesat e kryera, etj., janë çështje të zgjidhura me vendime të formës së prerë të organeve të drejtësisë dhe për to nuk mund të jepej një vlerësim i kundërt nga Komisioni, pasi cenohet parimi i gjësë së gjykuar dhe ai i sigurisë juridike. Pasuritë e subjektit të rivlerësimit i janë nënshtruar një hetimi pasuror të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si hetimi pasuror nr. {\*\*\*}, datë 07.01.2019, ku objekt hetimi dhe verifikimi kanë qenë pasuritë, të ardhurat, burimet e krijimit të tyre dhe detyrimet financiare të subjektit të rivlerësimit.

10.18.1. Në analizë të këtij shkakut ankimi, referuar vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier të datës 09.04.2021, trupi gjyqësor konstaton se kjo prokurori, pas



verifikimeve të kryera në kuadër të hetimit pasuror për referimin pasuror nr. 6, datë 07.01.2019, në ngarkim të R. G. dhe Dritan Ginës, me objekt dy pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të tyre, përkatësisht në Durrës dhe në Tiranë, ka vendosur mosfillimin e hetimit pasuror, duke arritur në konkluzionin se nuk ka mospërputhje rreth pasurive të deklaruara dhe se ato janë deklaruar rregullisht e janë krijuar me burime financiare të ligjshme. Ndër të tjera, vendimi i prokurorisë shprehet se [...] nuk rezultoi që këta shtetas të kenë bërë "Fshehje të pasurisë", që do të sillte më tej përfitimin pasuror të paligjshëm prej tyre, gjë që do të përbënte shkak të justifikuar ligjor për zhvillimin e hetimit pasuror, në bazë të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009. Gjithashtu, as në vendimin e KPK-së nr. 48, datë 25.07.2018, lënë në fuqi nga KPA-ja me vendimin nr. 12, datë 29.05.2019, për subjektin e rivlerësimit R. G., përsëri nuk u evidentua në asnjë moment fakti i fshehjes së pasurisë, për të legjitimuar më pas edhe fillimin e hetimit pasuror mbi të dhe bashkëshortin e saj Dritan Gina.

10.18.2. Në vijim të analizimit të këtij pretendimi, nga përmbajtja e vendimit të referuar nga subjekti i rivlerësimit, trupit gjykues i rezulton se prokurorët Dritan Gina dhe R. G. kanë qenë nën hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2<sup>52</sup> i Kodit Penal. Më datë 27.12.2018, kjo prokurori i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier pushimin e procedimit penal në ngarkim të tyre, e cila me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2019, e pranoi kërkesën për pushimin e këtij procedimi penal. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.04.2019. Trupi gjykues konstaton se pavarësisht kërkesës për pushimin e këtij procedimi penal, në dhjetor të vitit 2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, i ka dërguar informacion Prokurorisë së Krimeve të Rënda, e cila ishte kompetente në atë kohë për hetimet pasurore në aplikim të nenit 3, shkronja "d" e ligjit nr. 10192/2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar, e cila, pas veprimeve verifikuese të kryera prej saj në kuadër të këtij referimi pasuror, në datën 09.01.2020 ia përcolli materialet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, si prokuroria kompetente për të vazhduar veprime verifikuese të mëtejshme.

10.18.3. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në rrethanat konkrete nuk gjejnë zbatim parimet e gjësë së gjykuar dhe ai i sigurisë juridike, pasi referuar dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencës<sup>53</sup> së Kolegjit, procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është një proces i një natyre të posaçme dhe i jashtëzakonshëm, i cili nuk mbivendoset dhe as konkurren me procese të tjera. Në rastin konkret, procesi i rivlerësimit nuk kushtëzohet nga zgjidhja e çështjes penale, sipas vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier të datës 09.04.2021, pasi shkeljet disiplinore janë jo domosdoshmërisht edhe penale.

10.19. Komisioni, sipas subjektit të rivlerësimit, ka aplikuar standarde të dyfishta, duke cenuar parimin e barazisë para ligjit dhe të sigurisë juridike, pasi nuk ka marrë në konsideratë qëndrimet e mbajtura prej tij në raste të tjera ku janë trajtuar marrëdhënie juridike në kushtet e

<sup>52</sup> Neni 257/a i Kodit Penal parashikon veprën penale "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim".

<sup>53</sup> Vendimi nr. 22/2022 (JR), datë 22.06.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit R. S..



mirëbesimit ndërmjet personave me lidhje të ngushta familjare, duke referuar një sërë vendimesh të Komisionit, që sipas tij përbëjnë çështje të ngjashme.

10.19.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendime të tilla nuk përbëjnë shkak *apriori* për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e ankimuar e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve të dala nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike.

11. Në parashtrimet me shkrim të depozituara në Kolegji<sup>54</sup>, subjekti i rivlerësimit, duke përsëritur të njëjtat pretendime si në ankim, ka ngritur edhe disa pretendime të tjera, si vijojnë:
- (i) Përbërja e trupit gjykues të Kolegjit, në shumicë nga gjyqtarët Rezarta Schuetz, Sokol Çomo dhe Albana Shtylla, pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar ankimin e bashkëshortes R. G. kundër vendimit nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, cenon të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t'u gjykuar dhe dëgjuar nga një trupë gjyquese e paanshme, e caktuar me ligj.
  - (ii) Në zbatim të parimit të barazisë para ligjit dhe të parimit të objektivitetit, Kolegji duhet të mbajë të njëjtin standard që ka mbajtur Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar përmes vendimit të saj të formës së prerë nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2022, e cila e ka konsideruar të ligjshëm, të saktë, të rregullt dhe të plotë deklarimin e komisioneres E. Ç. në trajtimin e çështjes së saj.
  - (iii) Në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, Kolegji duhet të mbajë të njëjtin qëndrim si në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. M. O., bashkëshorte e subjektit të rivlerësimit G. O..

11.1 Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të pretendimeve që lidhen me përbërjen e tij në shumicë nga anëtarët Rezarta Schuetz, Sokol Çomo dhe Albana Shtylla, konstaton se këto pretendime janë trajtuar nga Kolegji në kuadër të kërkesave paraprake<sup>55</sup> të subjektit të rivlerësimit, përpara shqyrtimit në themel të çështjes, të cilat janë rrëzuar përkatësisht me vendimet e Kolegjit nr. 36, datë 12.12.2023; nr. 37, datë 12.12.2023 dhe nr. 38, datë 12.12.2023.

11.2 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit që lidhet me zbatimin e standardeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në rastin e komisioneres E. Ç., trupi gjykues sjell në vëmendje se referuar dispozitave kushtetuese, procesi i rivlerësimit kalimtar kryhet ndaj subjekteve të rivlerësimit që në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, janë gjyqtarët dhe prokurorët, dhe jo anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, dhe udhëhiqet ndër të tjera nga parimet e barazisë para ligjit dhe objektivitetit. Për shkak të juridiksionit të posaçëm dhe të jashtëzakonshëm kushtetues që kanë institucionet e rivlerësimit, çdo vendimmarrje e ankimuar e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve të dala

<sup>54</sup> Parashtrime, protokolluar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.12.2023.

<sup>55</sup> Kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Albana Shtylla, protokolluar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.11.2023; kërkesë për përjashtimin e gjyqtarës Rezarta Schuetz, protokolluar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.11.2023; kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Sokol Çomo, protokolluar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.11.2023.



nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike.

11.3 Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit që lidhet me zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. M. O., trupi gjykues, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016<sup>56</sup>, vlerëson se parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Nga analizimi i vendimit nr. 17/2022 (JR), datë 27.05.2022, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në ndryshim nga subjekti i rivlerësimit Dritan Gina, në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. M. O., objekt shqyrtimi ishin të tria kriteret e rivlerësimit, përfshirë edhe kontrollin e figurës dhe kriterin e vlerësimit profesional. Pamjaftueshmëria financiare e konstatuar në rastin e saj, për të cilën ishte dhënë më parë masa e shkarkimit nga detyra për bashkëshortin, subjekt rivlerësimi gjithashtu, në kushtet kur nuk janë konstatuar problematika për kontrollin e kriterit të figurës dhe kriterit të aftësive profesionale, është vlerësuar si e tillë që ka lejuar zbatimin e proporcionalitetit. Në rastin objekt shqyrtimi, siç do të shtjellohet më tej në këtë vendim, procesi i rivlerësimit ka përfunduar vetëm për kriterin e pasurisë dhe gjetjet e rezultuara që i përkasin jo vetëm kriterit të pasurisë, por edhe cenimit të besimit të publikut në vlerësimin tërësor të procedurave, përbëjnë shkelje që nuk lejojnë zbatimin e proporcionalitetit.

12. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike në prani të palëve, si dhe kontrolloi procesin e rivlerësimit të zhvilluar në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të kësaj dispozite, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit, nuk është i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje, mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion edhe për faktin se si më sipër evidentuar, aktet shkresore të cituara në ankim, nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me shkaqet ankimore për kriterin e pasurisë**

*Për pasurinë apartament me sipërfaqe 105 m<sup>2</sup>, në zonën e Shkëmbit të Kavajës, Durrës*

13. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, që nuk mbështeten nga dokumentacioni ligjor i administruar lidhur me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61, si dhe germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>56</sup> Neni 4, pikat 5 e 7 dhe neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.



14. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se deklarimi i tij është i saktë dhe përputhet plotësisht me dokumentacionin e administruar në Komision. Ai pretendon se ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në vlerën prej 44.400 eurosh, pagesë e cila është bërë me transfertë bankare në llogari të shoqërisë ndërtimore në cilësinë e palës shitëse, menjëherë pas disbursimit të kredisë në këtë shumë, me qëllim blerjen e këtij apartamenti.

15. Nga analiza e akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton si vijon.

15.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi, apartament në zonën e Shkëmbit të Kavajës, me sipërfaqe 105 m<sup>2</sup>, e regjistruar në ZVRPP Durrës, me adresë: “{\*\*\*}”, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me pjesë takuese 50%. Apartamenti deklarohet i blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, përmes kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore nr. {\*\*\*}, datë 06.10.2011, me çmim 80.000 euro. Si burim krijimi, deklarohet një kredi në shumën 45.000 euro në Raiffeisen Bank ShA, dhe 35.000 euro trajtim preferencial nga O. U., bashkëshorti i motrës së bashkëshortes R. G.. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2011, në të cilën diferenca prej 35.000 eurosh deklarohet dhuratë dhe në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, të po kësaj deklarate, thuhet se pjesa prej 35.000 eurosh për blerjen e apartamentit, është zbritje nga çmimi, duke u konsideruar si një trajtim preferencial nga shtetasi O. F. U., me shpjegimin se ai është bashkëshorti i motrës së bashkëshortes R. G..

15.1.1. Apartamenti, objekt shqyrtimi, rezulton të jetë përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes së një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.10.2011, nënshkruar mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, përfaqësuar nga z. O. U., sipas prokurës së përgjithshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.02.2008, dhe bashkëshortëve Dritan Gina dhe R. G.. Shlyerja e çmimit të shitjes prej 80.000 eurosh, sipas kontratës, parashikohet të kryhet: (i) kësti i parë, në shumën 30.000 euro, është parapaguar *cash* jashtë zyrës noteriale; (ii) kësti i dytë dhe i fundit, në shumën 50.000 euro, do të paguhet brenda datës 30.11.2011, duke u dokumentuar pagesa me transfertë bankare dhe deklaratë noteriale e nënshkruar mes palëve.

15.1.2. Me anë të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.11.2011, “Për pagimin e këstit të dytë dhe të fundit të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore të bërë me aktin noterial nr. 1548/744, datë 06.10.2011”, në zbatim të saj, palët kontraktore kanë konfirmuar pagesën e këstit të parë në shumën 30.000 euro, ose e konvertuar në shumën 4.214.100 lekë, ditën e lidhjes dhe nënshkrimit të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore të datës 06.10.2011, si dhe pranojnë se më datë 14.11.2011, është likuiduar *cash* dhe jashtë zyrës noteriale, kësti i dytë dhe i fundit i çmimit të shitjes, në shumën 7.023.500 lekë.

15.1.3. Ndërkohë, nga fatura e shitjes së ujit dhe largimit të ujërave të ndotura, të datës 5.8.2011, në emër të klientit Dritan Gina, paraqitur nga subjekti pranë ILDKPKI-së, faturimi i ujit për këtë apartament ka nisur në muajin korrik 2011. Në vijim, nga të dhënat e administruara prej OSHEE-së, ka rezultuar kontratë furnizimi me energji elektrike në emër të subjektit të rivlerësimit, me vendndodhje në Durrës, me datë hapje 27.10.2011.



15.1.4. Në datë 19.12.2011, është nënshkruar kontratë kredie bankare dhe hipotekare mes Raiffeisen Bank ShA dhe subjektit të rivlerësimit e bashkëshortes së tij, si bashkëkredimarrës, për financimin me kredi në shumën 45.214 euro, me qëllim blerje shtëpie, shumë e cila do të transferohet në llogari të palës shitëse shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas kontratës së shitblerjes së një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 06.10.2011. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2011, dhe referuar dokumentacionit bankar vijon rregullisht likuidimi i kësteve nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Referuar informacionit të përcjellë nga Raiffeisen Bank ShA, konfirmohet se Dritan Gina dhe bashkëshortja kanë marrë një kredi në shumën 45.214 euro, disbursuar në llogari të tij më datë 21.12.2011, ndërsa në datën 22.12.2011, shuma prej 44.400 eurosh është transferuar nga llogaria e subjektit në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrim: “Pagesë për blerje shtëpie sipas kontratës nr. {\*\*\*}”. Për sigurimin e kredisë është vendosur hipotekë mbi pasurinë objekt shqyrtimi. Ndërkohë, nga të dhënat në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, drejtuar ILDKPKI-së, burimi i fondeve për blerjen e apartamentit të banimit në shumën 80.000 euro, përshkruhet “nga puna”.


15.1.5. Përmes një deklaratë me shkresë të thjeshtë, të datës 19.01.2017, z. O. U. deklaron se në cilësinë e ortakut dhe përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në kontratën e shitblerjes me objekt pasurinë me nr. {\*\*\*}, ka realizuar një zbritje preferenciale prej 35.000 eurosh, mbi çmimin e përgjithshëm prej 80.000 eurosh, për palën blerëse R. G., motra e bashkëshortes së tij E. G.. Në vijim, nga ana e ILDKPKI-së është administruar edhe një tjetër dokument nga kjo shoqëri, konkretisht shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 01.08.2017, përmes së cilës shoqëria “{\*\*\*}” ShPK informon ndër të tjera lidhur me faktin e aplikimit të një çmimi preferencial në rastin e blerësve Dritan Gina dhe R. G., për shkak të lidhjes së posaçme familjare mes tyre dhe ortakut të shoqërisë O. U., duke zbritur nga çmimi i parashikuar në kontratë, vlerën e detyrimit prej 35.000 eurosh. Kjo shoqëri ka sqaruar se deklarimi i shlyerjes edhe të pjesës tjetër të çmimit prej blerësve në favor të shoqërisë, është bërë për efekt të garantimit të kalimit të të drejtës së pronësisë mbi këtë apartament banimi të blerësit, me qëllim për t’u mundësuar atyre vënien në hipotekë të tij, si mjet për të garantuar lëvrimin e kredisë së kërkuar te “Raiffeisen Bank”.

15.2. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës lidhur me konstatimet si vijojnë:

(i) Ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerën reale të paguar, kohën e pagesës, si dhe burimin përkatës të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie të paluajtshme.

(ii) Nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kështit të parë të çmimit të blerjes së apartamentit, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2011 - 06.10.2011, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.909.121 lekë; (iii) nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e çmimit të plotë të blerjes së apartamentit, në vlerën 80.000 euro, deri në datën 14.11.2011, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 01.01.2011 - 04.11.2011, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 8.870.932 lekë.

15.2.1. Për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, me shpjegimet e tij



të datës 12.07.2021, subjekti i rivlerësimit ka informuar Komisionin lidhur me faktin se në përfundim të një hetimi pasuror të nisur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier mbi pasuritë e tij dhe burimet e krijimit të tyre më datë 09.04.2021, kjo pasuri kishte rezultuar e deklaruar rregullisht dhe e krijuar me burime të ligjshme. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Komision dokumentacionin<sup>57</sup> e administruar nga kjo prokurori në kuadër të hetimit pasuror, nga Raiffeisen Bank ShA, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, dhe deklarimet e shtetasit O. U., si dhe ka riparaqitur deklaratat e mëparshme të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe një tjetër deklaratë noteriale të vitit 2021 të kësaj shoqërie. Nga verifikimi i këtyre akteve, vihet re se ato rikonfirmojnë faktet e zbritjes preferenciale për shkak të marrëdhënies së afërt familjare, qëllimin e marrjes së kredisë posaçërisht për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi dhe pagesën e vetme të paguar ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në shumën 44.400 euro. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 15.09.2021 në Komision, trupi gjykues konstaton se ai ka vijuar të mbajë të njëjtin qëndrim, duke u shprehur që shuma prej 35.000 eurosh ishte një trajtim preferencial i deklaruar që në vitin 2011, dhe se nuk ka asnjë provë apo fakt që të vërtetojë që kjo shumë është paguar prej tij.

15.3. Nga analizimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ai kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, por pa ngritur një shkak të posaçëm ankimi, pa dhënë argumente, si dhe pa paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e tij. Lidhur me pretendimin mbi saktësinë e deklarimeve për këtë pasuri, si përputhshmërinë e tyre me dokumentacionin e administruar nga Komisioni, trupit gjykues i rezultoi e provuar ekzistenca e mospërputhjeve lidhur me vlerën e paguar të kësaj pasurie, kohën e kryerjes së saj, si dhe burimin e krijimit, si vijojnë: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* se kjo pasuri është blerë me kredi bankare në shumën 45.000 euro, marrë më datë 19.12.2011, dhe 35.000 euro trajtim preferencial, nuk përputhet me kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të paluajtshme të datës 6.10.2011, sipas së cilës: (a) kësti i parë në shumën 30.000 euro i është parapaguar *cash* palës blerëse jashtë zyrës noteriale; (b) kësti i dytë dhe i fundit në shumën 50.000 euro, nga pala blerëse do të paguhej brenda datës 30.11.2011; (ii) deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk përputhet as me deklaratën noteriale të datës 14.11.2011, e lidhur në zbatim të kontratës së shitjes, sipas së cilës, pasi konfirmohet edhe një herë nga palës pagesa e kështit të parë prej 30.000 eurosh në ditën e lidhjes së kontratës së shitjes së datës 06.10.2011, pranohet se në datën 14.11.2011 nga pala blerëse është dorëzuar *cash* jashtë zyrës noteriale, kësti i dytë dhe i fundit i çmimit të shitjes, në shumën 7.023.500 lekë; (iii) deklarimi i subjektit se shuma prej 44.400 eurosh, e paguar prej tij ka si burim kredinë e marrë pranë

<sup>57</sup> Deklaratë e thjeshtë e datës 06.10.2011, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ortakut O.U.; deklaratë e thjeshtë nr. {\*\*\*}, datë 19.01.2017, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; formularët e aplikimit për kredi konsumatore të subjektit të rivlerësimit, të lëshuar nga Raiffeisen Bank ShA më datë 08.07.2021; praktika e kontratës së kredisë bankare dhe hipotekare me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.12.2011; shkresa kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 17.04.2018, e Raiffeisen Bank ShA; kërkesë për transfertë fondesh e datës 21.12.2021, e kredimarrësit Dritan Gina; nxjerrje llogarie, lëshuar nga Raiffeisen Bank ShA në datën 01.02.2012; procesverbali i deklarimeve të dhëna nga shtetasi O. U., ortak i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; deklarimet e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe dokumentacioni shoqëruar administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.06.2018; dokumentacion juridik dhe ekonomik-financiar i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në lidhje me klientët Dritan Gina dhe R. G.; deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.07.2021, e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.




Raiffeisen Bank ShA, nuk përputhet me dokumentacionin bankar sipas të cilit kredia është marrë më datë 19.12.2011 dhe është disbursuar më datë 21.12.2011, ndërkohë që apartamenti tashmë ishte regjistruar në pronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij që më datë 07.12.2011, pa barrë hipotekore; (iv) deklarimi i subjektit në deklaratën *vetting* se si burim krijimi të kësaj pasurie kanë shërbyer kredia bankare në shumën 45.000 euro dhe një trajtim preferencial nga shtetasi O. U., në shumën 35.000 euro, nuk përputhet me të dhënat në shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, drejtuar ILDKPKI-së, sipas së cilës burimi i fondeve për blerjen e apartamentit të banimit në shumën 80.000 euro, përshkruhet “nga puna”.

15.4. Për të konkluduar në lidhje me saktësinë e deklaramit në deklaratën e pasurisë *vetting*, e për pasojë dhe të verifikimit mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit u ndal fillimisht në analizimin e forcës provuese të akteve noteriale të nënshkruara mes palëve kontraktore. Nën dritën e përcaktimeve të nenit 690<sup>58</sup> të Kodit Civil, lexuar në raport me nenin 253<sup>59</sup> të Kodit të Procedurës Civile, kontrata e shitblerjes me rezervë ligjore e datës 6.10.2011 dhe deklarata noteriale e datës 14.11.2011 kanë forcën e ligjit për palët dhe përbëjnë provë të plotë të deklaramive të tyre para noterit për faktet që kanë ngjarë në prani të tij, sikurse është dhe fakti i likuidimit të plotë të çmimit të apartamentit me dy këste, i pari në shumën 30.000 euro dhe i dyti në shumën 50.000 euro, përkatësisht në datat 06.10.2011 dhe 14.11.2011. Këto dy akte noteriale kanë prodhuar efekte edhe lidhur me faktin e regjistrimit të pasurisë në pronësi të palës blerëse, pasi përmes tyre është realizuar regjistrimi i pasurisë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij më datë 07.12.2011, përpara marrjes së kredisë më datë 19.12.2011. Për më tepër, nuk rezulton që palët të kenë ushtruar të drejtat për t’u tërhequr nga kontrata përpara nisjes së zbatimit të saj sipas neneve 696 dhe 698 të Kodit Civil dhe as është kërkuar pavlefshmëri e aktit noterial sipas nenit 68 të ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994, “Për noterinë” i ndryshuar, çka dëshmon për fuqinë e plotë provuese të saj.

15.4.1. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se mospërputhjet në lidhje me çmimin e paguar, kohën dhe burimin e krijimit, në kushtet kur këto akte kanë prodhuar pasoja të plota lidhur me likuidimin e çmimit të shitjes dhe regjistrimin e pasurisë në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, nuk mund të justifikohen as nga kryerja e veprimeve të mëpasshme, siç është marrja e kredisë dhe transferimi i shumës së disbursuar te shoqëria blerëse. Për më tepër, në datën e lidhjes së kontratës së shitjes 6.10.2011, nga ana e subjektit ende nuk ishte bërë fakt aplikimi për kredi në Raiffeisen Bank ShA, veprime të cilat sikurse i janë konfirmuar subjektit nga kjo bankë, kanë ndodhur më vonë në kohë, konkretisht aplikimi i parë i përket datës 10.11.2011, ndërsa riaplikimi i përket datës 23.11.2011. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos konsideruar si burim krijimi për blerjen e pasurisë apartament, kredinë bankare.

<sup>58</sup> Në nenin 690 të Kodit Civil, përcaktohet se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkak të parashikuara me ligj”.

<sup>59</sup> Në nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet se: “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramive që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.





15.5. Lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij për blerjen e këtij apartamenti, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu kontrollin e analizës financiare të Komisionit duke konsideruar likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit në Durrës, në linjë me Komisionin, sipas përcaktimeve në kontratën e shitjes dhe deklaratën noteriale me dy këste si vijojnë: kësti i parë në vlerën 4.214.100 lekë (30.000 euro x 140,47 lekë), në datë 06.10.2011; kësti i dytë në vlerën 7.023.500 lekë (50.000 euro x 140,47 lekë), në datë 14.11.2011. Në përfundim, trupi gjykues konfirmon pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 105 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës.

15.6. Në konkluzion të sa analizuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe 121,36 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*

16. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni, pasi ka arsyetuar mbi fuqinë provuese të kontratës së shitjes në kushtet e moskundërshtimit të saj sipas ligjit, ka arritur në përfundimin se *shlyerja e plotë e shumave objekt kontrate dhe kalimi i pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm është bërë sipas kontratës së datës 12.11.2013, dhe në secilin prej skenarëve të mundshëm të pagimit të çmimit nga subjekti dhe bashkëshortja, sipas parashikimeve të kontratës ligjore të nënshkruar mes tyre, lidhur me blerjen e apartamentit, do të rezultojnë me pamjaftueshmëri financiare.* Në konkluzion, Komisioni ka vlerësuar se: *Për sa kohë, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore, pasi të dhënat nuk mbështeteshin nga dokumentacioni ligjor nënshkruar mes palëve, të cilat lidheshin me justifikimin e burimeve të kësaj pasurie, e vendosin në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61, si dhe të germës “a”, pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*
17. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke ngritur të njëjtat pretendime me të cilat ka kundërshtuar barrën e provës të ngarkuar nga Komisioni. Ai pretendon se, ashtu sikurse ka rezultuar në përfundim të hetimit pasuror të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier<sup>60</sup>, deklaratimet e tij në lidhje me këtë pasuri, pagesa e kryer, burimi i financimit dhe deklaratat e palëve të përfshira në këtë marrëdhënie juridike përputhen plotësisht me dokumentacionin e dorëzuar dhe të administruar nga institucionet shtetërore, dhe se burimet e krijimit të kësaj pasurie janë të ligjshme.
18. Nga analiza e akteve të dosjes gjyqësore në lidhje me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se:
  - 18.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi apartament banimi me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, ndodhur në adresën: rruga “{\*\*\*}” ose “{\*\*\*}”, sipas certifikatës së

<sup>60</sup> Vendim i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i datës 09.04.2021, “Për mosfillimin e hetimit pasuror për referimin pasuror nr. {\*\*\*}, datë 07.01.2019”.



pronësisë me nr. {\*\*\*}, lëshuar më datë 22.6.2012<sup>61</sup>. Si burim krijimi i kësaj pasurie, deklarohet dhurim nga babai i bashkëshortes, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*}, datë 02.11.2013. Apartamenti deklarohet i regjistruar në pronësi të z. Dritan Gina dhe znj. R. G., me pjesë takuese 50%. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2013. Ashtu si në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore, si burim krijimi i kësaj pasurie deklarohet dhurim nga babai i *deklarueses* me deklaratë noteriale, duke shtuar faktin se ai e ka poseduar këtë pronë që prej vitit 2004.

**18.1.1.** Përmes deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 02.11.2013, të palëve shoqëria ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, investitorit T. M., si dhe deklaruesit N. G., R. G. dhe Dritan Gina deklarohen dhe konfirmohen faktet si vijojnë: (i) nënshkrimi i një kontrate porosie më datë 28.10.2004, mes shoqërisë ndërtuese, investitorit T. M. dhe z. N. G., kontratë e vërtetuar pranë noterit pas 9 (nëntë) vitesh me nr. {\*\*\*} rep., datë 02.11.2013. Në kontratën e porosisë është përcaktuar objekti, blerja e një apartamenti me sipërfaqe 107,59 m<sup>2</sup>, në adresën: rr. “{\*\*\*}” ({\*\*\*}), në vlerën 38.800 USD, shumë e likuiduar nga blerësi N. G. në favor të shitësit, investitorit T. M.; (ii) deklarimi i z. N. G. se pasi ka rregulluar të gjitha marrëdhëniet financiare me investitorin T. M., ka vendosur të heqë dorë nga pronësia e apartamentit dhe t’ia dhurojë atë vajzës së tij R. G. dhe bashkëshortit të saj Dritan Gina, pranuar dhe dakordësuar ky fakt nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me administrator A. B. dhe investitor T. M.; (iii) shfuqizimi i kontratës së sipërmarrjes së datës 28.10.2004, me vërtetim nënshkrimi nr. {\*\*\*} rep., datë 02.11.2013.

**18.1.2.** Më datë 12.11.2013, për këtë apartament është nënshkruar kontrata e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., mes palëve R. G. e Dritan Gina në cilësinë e blerësve dhe shoqërisë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK e investitorit T. M. në cilësinë e shitësve. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes në shumën 38.800 USD, është likuiduar totalisht prej blerësve në favor të investitorit, përpara regjistrimit në ZVRPP Tiranë dhe jashtë zyrës noteriale. Më tej, ky apartament është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij sipas certifikatës për vërtetim pronësie të datës 20.11.2013, lëshuar nga ZVRPP Tiranë, me shënimin kontratë shitblerjeje, datë 12.11.2013. Ndërkaq, referuar deklaratimeve periodike vjetore, adresa e këtij apartamenti është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si adresë banimi që prej vitit 2006, ndërsa nga bashkëshortja R. G., adresa e këtij apartamenti është deklaruar si adresë banimi që prej vitit 2004.

**18.1.3.** Në vijim, Komisioni ka administruar informacionin e marrë nga OSHEE-ja<sup>62</sup>, përmes të cilit konfirmohet fakti se kontrata e furnizimit me energji elektrike që furnizon këtë apartament, figuron në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa referuar të dhënave mbi abonentin, si datë e hapjes së kontratës, figuron data 18.11.2004, me shënimin: “T. M. në Dritan Gina pro {\*\*\*}, dt. 23.3.2015, {\*\*\*} me e-mail, dt. 23.07.2015, M. U.”. Nga ana e Komisionit është administruar gjithashtu edhe dokumenti “Formular i prezantimit të kërkesës ose ankesës të OSHEE ShA, me nr. serie {\*\*\*}, datë 11.03.2015”, përmes të cilit vihet re se abonenti T. M. kërkon ndryshim të të dhënave të kontratës nga T. M. në Dritan Gina. Nga të

<sup>61</sup> Sipas kësaj certifikate vërtetohet regjistrimi i kësaj pasurie në emër të pronarit të mëparshëm, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>62</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 11.1.2018, nga OSHEE-ja.



dhënat e marra nga UKT-ja<sup>63</sup>, konfirmohet fakti se kontrata e furnizimit me ujë që furnizon këtë apartament, figuron në emër të subjektit të rivlerësimit Dritan Gina, ndërsa referuar informacionit mbi abonentin, si datë e hapjes së kontratës figuron data 31.10.2004.

18.2. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, duke ngritur dyshimin se ky apartament është blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.10.2004, kundrejt shumës 38.800 USD, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi atij barrën e provës për: (i) deklaram të pasaktë; (ii) mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e blerjes së këtij apartamenti në datën 28.10.2004, në shumën 38.800 USD, si dhe balancën negative në vlerën 3.142.936 lekë, për periudhën 01.01.2004 - 28.10.2004. Në shpjegimet mbi këto rezultate, ashtu si dhe për pasurinë në Durrës të trajtuar më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka qenë objekt hetimi pasuror nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nga i cili kishte rezultuar se kjo pasuri ishte deklaruar rregullisht dhe e krijuar me burime të ligjshme. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur në Komision dokumentacionin e administruar nga kjo prokurori në kuadër të hetimit pasuror prej noteres N. K., OSHEE, UKT, deklaramet e shtetasit T. M., si dhe dy deklarata noteriale të vitit 2018 të shtetasve N. G. dhe T. M.. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 15.09.2021 në Komision, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vijuar të mbajë të njëjtin qëndrim, se apartamenti objekt shqyrtimi ishte blerë në vitin 2004 nga babai i bashkëshortes së tij, përpara se ata të lidhnin martesë. Më tej, ai ka sqaruar se kontrata e energjisë elektrike e hapur në vitin 2004, nuk ka qenë në emrin e tij, por të subjektit “{\*\*\*}” ShPK, e më pas ka kaluar në emër të investitorit T. M..

18.3. Në drejtim të saktësisë së deklarameve të tij dhe përputhshmërisë me dokumentacionin ligjor të administruar nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton e provuar ekzistenca e mospërputhjeve mes deklarameve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar se apartamenti është dhurim nga babai i bashkëshortes përmes deklarames noteriale nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 02.11.2013, ndërkohë në pikën 3.2 të kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr {\*\*\*} kol., datë 12.11.2013, të nënshkruar nga bashkëshortët R. G. dhe Dritan Gina në cilësinë e blerësve të kësaj pasurie, parashikohet se: *R. G. dhe Dritan Gina i kanë likuiduar totalisht investitorit T. M., çmimin e shitjes prej 38.800 USD [...] të vendosur për apartamentin e mësipërm, përpara regjistrimit të këtij apartamenti në ZVRPP Tiranë dhe jashtë kësaj zyre noteriale.* Ndërkaq, referuar deklarameve periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë të plotë banimi që prej vitit 2006 e në vijim, adresën: *Njësia administrative nr. {\*\*\*}, rr. “{\*\*\*}”, Tiranë*, ndërsa nga bashkëshortja R. G., që në deklaramin për vitin 2004, është deklaruar adresa: *rr. “{\*\*\*}”, pas pallateve 9-katëshe.*

18.4. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi ligjshmërinë dhe mjaftueshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni fillimisht në rezultatet e hetimit administrativ, ka ngritur dyshimin se ky apartament ishte blerë nga subjekti i rivlerësimit në datën 28.10.2004, duke i kaluar barrën e provës për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e blerjes së këtij apartamenti në datën

<sup>63</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*}, datë 10.01.2018, nga UKT-ja.



28.10.2004, në shumën 38.800 USD, për shkak të një balance negative në vlerën 3.142.936 lekë, ndërsa në vendim, edhe pse arsyetohet mbi fuqinë provuese të kontratës së shitjes të datës 12.11.2013, dhe pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit në të gjithë skenarët e mundshëm, duke nënkuptuar në vitin 2004 dhe 2013, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 61, si dhe të germës “a”, pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dispozitë kjo që parashikon kryerjen e deklaramit të pasaktë, por nuk mban qëndrim mbi rezultatin financiar të konstatuar gjatë hetimit administrativ, për të evidentuar balancën negative për krijimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, në përputhje me standardin e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vlerëson që për këtë pasuri, ashtu si dhe Komisioni, të konkludojë se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pasaktë lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë, depozitë në Credins Bank ShA, në vlerën 10.000 euro, çelur më datë 23.12.2016*

19. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në vitin 2016, sipas parashikimeve të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
20. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se: (i) nuk mund të vihen në dyshim deklaramit e tij, për sa kohë janë vlerësuar të sakta dhe me burime të ligjshme të mjaftueshme në vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, lënë në fuqi nga Kolegji me vendimin (JR) nr. 12, datë 29.05.2019, që i përket bashkëshortes, znj. R. G.; (ii) deklaramit për këtë pasuri është i saktë dhe në përputhje me ligjin, përderisa Komisioni ka arritur në konkluzionin se deklaramit e subjektit në lidhje me këtë depozitë përputhen me dokumentacionin e disponuar nga Credins Bank ShA; (iii) burimet e krijimit të kësaj depozite janë të ligjshme e të mjaftueshme, pasi vlera e saj në datën 23.12.2016, në shumën 10.000 euro, është më e vogël se gjysma e kursimeve të deklaruara rregullisht ndër vite në deklaratat periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja; (iv) nga të ardhurat dhe kursimet, nuk duhet të zbritet shuma 44.400 euro për blerjen e shtëpisë në Durrës në vitin 2011, pasi për të është përdorur kredia bankare e marrë për këtë qëllim, si dhe shuma 38.800 USD, përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi kjo shumë është paguar nga z. N. G..
21. Nga analizimi i këtyre pretendimeve dhe akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se:

21.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron: *Depozitë në Credins Bank, çelur në datë 23.12.2016, në shumën 10.000 euro, në emër të R. G., sipas vërtetimit të datës 18.1.2017 të Credins Bank. Si burim krijimi i kësaj depozite, deklarohen kursimet ndër vite nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij, të deklaruara deri në vitin 2015 si gjendje cash. Pjesa takuese 50%. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin burim krijimi edhe në deklaratën periodike vjetore 2016.*

21.2. Referuar informacionit të përcjellë nga Credins Bank ShA, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 11.08.2020, rezulton se në datën 23.12.2016, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e saj në euro, shumën prej 10.000 eurosh.




21.3. Në kushtet kur si burim krijimi për këtë depozitë janë deklaruar kursimet ndër vite të subjektit dhe bashkëshortes, deklaruar si gjendje *cash* në deklaratat e interesave privatë vjetorë deri në vitin 2015, që kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj pasurie, konstatohet si vijon:

- o Në DIPPV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën 500.000 lekë, pa dhënë specifikime, pjesa takuese 100%. Bashkëshortja në deklaratën e saj ka deklaruar likuiditet në banesë, në vlerën 300.000 lekë, nga shitja e automjetit, tip "Fiat Punto", dhe 500.000 lekë kursime nga paga e vitit 2005, pjesa takuese 100%.
- o Në DIPPV-të 2006 deri në 2009, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar kursime në *cash*.
- o Në DIPPV-2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shtuar kursimet me të ardhurat nga pagat në vlerën 400.000 lekë, pjesa takuese 100%*. Bashkëshortja ka deklaruar: *shtuar kursime me të ardhura nga pagat në vlerën 500.000 lekë, pjesa takuese 100%*.
- o Në DIPPV-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shtuar kursimet me të ardhurat nga paga në vlerën 300.000 lekë, pjesa takuese 100%*. Bashkëshortja ka deklaruar: *shtuar kursime me të ardhura nga paga në vlerë 200.000 lekë*.
- o Në DIPPV-2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shtuar kursimet me burim të ardhurat nga paga në vlerën 100.000 lekë, pjesa takuese 100%*. Bashkëshortja ka deklaruar: *shtuar kursime me të ardhura nga paga, vlera 200.000 lekë, pjesa takuese 100%*.
- o Në DIPPV-2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë deklaruar kursime në *cash*.
- o Në DIPPV-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *kursime të përbashkëta nga paga e tij dhe e bashkëshortes në vlerën 500.000 lekë, pjesa takuese 50%*.
- o Në DIPPV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *kursime të përbashkëta nga paga së bashku me bashkëshorten në vlerën 300.000 lekë, pjesa takuese 50%*. Bashkëshortja në deklaratën e saj të këtij viti, ka bërë të njëjtin deklaram, duke shtuar se: *Gjendja në total, së bashku me kursime të një viti më parë, është 800.000 lekë*.

21.4. Në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, ndodhur në kushtet kur nuk është ngritur shkak ankimor nga subjekti i rivlerësimit, znj. R. G., lidhur me pasurinë depozitë në vlerën 10.000 euro, çelur më 23.12.2016, në Bankën Credins ShA, trupi gjykues konstaton se kjo pasuri nuk i është nënshtruar kontrollit nga ana e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 12, datë 29.05.2019, të tij që i përket bashkëshortes së subjektit, znj. R. G.. Fakti që Kolegji nuk është shprehur në vendimin e sipërcituar për këtë pasuri, nuk nënkupton *apriori* se deklaramet në lidhje me të janë të sakta dhe ka burime të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e saj.

21.5. Në lidhje me pretendimin tjetër se deklarimi i tij për këtë pasuri është i saktë dhe në përputhje me ligjin, në kushtet kur vetë Komisioni ka arritur në konkluzionin se këto deklarime përputhen me dokumentacionin e përcjellë Credins Bank ShA, trupi gjykues vlerëson konstatimi i përputhshmërisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë



*vetting*, me dokumentacionin e administruar, nuk të çon *apriori* në vlerësimin mbi saktësinë e deklarimeve, pasi i vetëm informacioni bankar është i pamjaftueshëm në arritjen e një konkluzioni të tillë, për sa kohë ky informacion konfirmon vetëm kryerjen e veprimit të depozitimit të shumës dhe balancat e llogarive në fund të vitit, por jo burimet e krijimit të saj. Në kuptim të normave kushtetuese që rregullojnë procesin e rivlerësimit, që një deklaram të konsiderohet i saktë, duhet t’u përmbahet përcaktimeve të nenit D, pikat 1, 2 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilave saktësia e deklaramit lidhet me plotësinë e tij dhe me shpjegimin bindshëm të burimit të krijimit të pasurisë.

21.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se burimet e krijimit të kësaj depozite janë të ligjshme dhe të mjaftueshme pasi vlera e saj në datën 23.12.2016, në shumën 10.000 euro, është më e vogël se gjysma e kursimeve të deklaruara rregullisht në deklaratat periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij ndër vite si kursime nga pagat, që deri në datën 31.12.2015 kanë qenë në vlerën prej 3.800.000 lekësh, trupi gjykues i Kolegjit analizoi deklaramet e kursimeve *cash* nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në deklaratat periodike vjetore 2005 – 2015, si dhe kontrolloi analizën financiare të kryer në Komision për verifikimin e mundësisë financiare të bashkëshortëve Dritan Gina dhe R. G., për krijimin e këtyre kursimeve. Në përfundim të kontrollit të kësaj analize, trupi gjykues konfirmon pamjaftueshmërinë në vlerën e konstatuar nga Komisioni, të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për krijimin e kursimeve në shumat e deklaruara *cash* për periudhën 2005 – 31.12.2015, totalin e të cilave e pretendon si burim krijimi të depozitës 10.000 euro në datën 23.12.2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme edhe për krijimin e shumës prej 5.000 eurosh gjendje *cash* në banesë, deklaram në deklaratën *vetting* me të njëjtin burim krijimi sikurse depozita në shumën 10.000 euro.

21.7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurave dhe kursimeve të tij nuk duhet t’u zbritet vlera 44.400 euro për blerjen e shtëpisë në Durrës në vitin 2011, pasi për të është përdorur kredia bankare e marrë për këtë qëllim. Ai ngre të njëjtin pretendim edhe për vlerën 38.800 USD, përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, pasi kjo shumë është paguar nga z. N. G.. Në vlerësim të trupit gjykues, këto pretendime nuk qëndrojnë pasi, sikurse arsyetuar në paragrafët 15.4.1 dhe 15.5 të këtij vendimi, kredia bankare nuk është konsideruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit në Durrës, ndërkohë, sikurse arsyetuar në paragrafët 18.3 dhe 18.4 të këtij vendimi, trupi gjykues e konsideroi apartamentin në Tiranë, të blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij dhe në çdo skenar të analizës financiare, ata rezultojnë me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për blerjen e tij.

21.8. Në përfundim, për këtë pasuri, trupi gjykues, në përputhje me standardin e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, konfirmon pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, të konstatuar nga Komisioni, në vlerën (-) 1.069.317 lekë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Për pasurinë automjet, tip “Peugeot 308”*

22. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit për vitet e mbyllura*



2011 dhe 2013, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shpenzimet e qirasë financiare Leasing për automjetin tip "Peugeot 308", blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara për këto vite.

23. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit duke pretenduar se: (i) deklaratimet dhe burimet e krijimit të saj nuk mund të vihen në dyshim, për sa kohë janë vlerësuar të sakta dhe me burime të ligjshme të mjaftueshme në vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, lënë në fuqi nga Kolegji me vendimin (JR) nr. 12, datë 29.05.2019, që i përket bashkëshortes, znj. R. G.; (ii) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe në përputhje me ligjin, për sa kohë Komisioni ka arritur në konkluzionin se deklaratimet e subjektit në lidhje me këtë pasuri, përputhen me dokumentacionin e disponuar nga Credins Bank ShA.
24. Nga analizimi i shkaqeve të ankimit dhe akteve të administruara në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se:

24.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. R. G., deklaron: *Autoveturë, tip "Peugeot 308", me targë {\*\*\*}, në emër të R. G., blerë me kontratën e qirasë financiare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.09.2010, në Credins Leasing, me vlerë 15.100 euro, në pronësi 100%*. Në deklaratën e interesave private për vitin 2010, nga subjekti i rivlerësimit deklorohet: *Marrë një kredi në Credins Leasing për blerjen e një autoveture "Peugeot 308", targa {\*\*\*}. Kredia është marrë në 20.09.2010, në shumën 12.000 euro. Makina është blerë në shumën 15.100 euro. Është shlyer 3.100 euro. Në këtë deklaratë, gjithashtu thuhet se: Kredia është marrë nga bashkëshortja R. G.. Unë jam në rolin e garantit në rast mosshlyerje të detyrimit.*

24.2. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje financiare nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 21.09.2010, mes shoqërisë aksionere Credins Leasing në cilësinë e qiradhënësit, znj. R. G. në cilësinë e qiramarrëses dhe z. Dritan Gina në cilësinë e dorëzanesit, me qëllim financimin me qira financiare *Leasing*, në shumën 12.120 euro, me afat 60 muaj, për blerjen e automjetit të markës "Peugeot 308", në çmimin 15.120 euro. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.07.2021, Credins Bank ShA konfirmon se në datën 18.09.2010, subjekti i rivlerësimit ka likuiduar *cash* në arkë, shumën 3.780 euro. Shoqëria anonime Credins Leasing, me vërtetimin nr. prot. {\*\*\*}, datë 18.09.2016, informon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk ka detyrime për qiranë financiare. Referuar praktikës së përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor<sup>64</sup>, ky automjet i përfituar përmes kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 3.9.2016, figuron i regjistruar në pronësi të znj. R. G..

24.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se saktësia dhe mundësia financiare për këtë automjet nuk mund të vihen më në dyshim, për sa kohë ato janë vlerësuar të sakta dhe të ligjshme në vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit, lënë në fuqi me vendimin (JR) nr. 12, datë 29.05.2019, të Kolegjit, trupi gjykues vëren se në këtë vendim, i cili i përket subjektit të rivlerësimit, znj. R. G., person i lidhur me subjektin Dritan Gina, për sa kohë nuk është ngritur shkak ankimor në lidhje me pasurinë automjet, i markës "Peugeot 308", kjo pasuri nuk i është

<sup>64</sup> Shkresë kthim përgjigjeje nr. {\*\*\*} prot., datë 04.01.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.



nënshtuar kontrollit të Kolegjit. Fakti që Kolegji nuk është shprehur për çështjen që i përket bashkëshortes në lidhje me këtë pasuri, për arsyen më sipër, nuk nënkupton *a priori* se deklaratimet në lidhje me të janë të sakta dhe ka burime të ligjshme e të mjaftueshme për krijimin e saj.

24.4. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, nuk ka konkluduar lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve financiare për krijimin e pasurisë automjet objekt shqyrtimi, edhe pse në raport mbi rezultatet e hetimit administrativ, është konstatuar balancë negative për vitin 2010, vit në të cilin është likuiduar kapitali fillestar dhe shpenzimet për qiranë *leasing*, në shumën 3.780 euro, dhe janë shlyer këste të qirasë financiare nga muaji tetor 2010 deri në shtator 2015. Komisioni në vendim konkludon në pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për shlyerjen e qirasë financiare për vitet 2011 dhe 2013.

24.5. Trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni për këtë qëllim, dhe konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme për shlyerjen e detyrimeve të qirasë financiare *leasing*, në vlerën (-) 1.636.307 lekë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

25. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
26. Nga analizimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se prej tij janë ngritur shkaqe ankimore edhe për kriterin e kontrollit të figurës, ndërkohë që Komisioni në vendim nuk ka arritur në një konkluzion për këtë kriter. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pavend analizimin e shkaqeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë kriter, dhe pa ndonjë efekt në vendimmarrjen e tij.
27. Trupi gjykues i Kolegjit, në vijim të trajtimit të shkaqeve të ankimit në paragrafët 10.15 dhe 10.16 të këtij vendimi, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit duket se nuk e ka kundërshtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë konkluzionin e Komisionit lidhur me cenimin e besimit të publikut, e për pasojë edhe aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e gjen me vend të ndalet në kontrollin e zbatueshmërisë së kësaj dispozite. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ligjvënësi në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar të drejtën e Komisionit dhe Kolegjit, që në kuadër të këtij procesi, të marrin vendime jo vetëm bazuar në një ose disa prej kriterëve apo vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, por edhe në vlerësimin tërësor të procedurave, duke përcaktuar në nenin 48 të këtij ligji, se gatishmëria dhe sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi mbahen parasysht nga këto organe në marrjen e vendimit. Në këto kushte, cenimi i besimit të publikut, që sjell si pasojë zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vjen në harmoni me dispozitat e cituara më sipër, nëse ndodhemi përpara një sjelljeje jokorrekte të subjekteve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit.





28. Trupi gjykues konstaton se faktet dhe rrethanat e analizuara në çështjen objekt shqyrtimi, të konsideruara si cenim i besimit të publikut, duke e kualifikuar subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, lidhen me qëndrimin jobashkëpunues të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Kjo mungesë bashkëpunimi konsiston në:

28.1. Kërkesat procedurale për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues në Komision. Në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, këto kërkesa nuk kanë pasur për qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por zvarritjen e tij, gjë që konstatohet dukshëm me kërkesat në mënyrë të vazhdueshme, të përsëritura dhe të pabazuara të trajtuara si në paragrafët 10.2 – 10.5.4 të këtij vendimi, si para dhe gjatë seancave dëgjimore, duke mos treguar predispozicion dhe një sjellje korrekte në drejtim të procesit të rivlerësimit. Në vlerësim të trupit gjykues, në çdo rast, subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të paraqesë kërkesa procedurale në kuadër të këtij procesi, por jo ato që dukshëm kalojnë kufirin mbrojtjes për të rënë në abuzivitet.

28.2. Sjelljen e subjektit të rivlerësimit si përpara nisjes së seancës dëgjimore të datës 22.09.2021, ashtu dhe në nisje të kësaj seance. Më konkretisht, mosparaqitja e kartës së identitetit dhe moslejimi i kontrollit fizik nga Garda e Republikës, përpara nisjes së seancës dëgjimore, dhe më pas hyrja forcërisht në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore, demonstrojnë mungesë respekti e vetëpërmbytjeje, si dhe një qasje të papërshtatshme e ofensive ndaj institucioneve shtetërore dhe autoritetit të tyre. Sjellje të tilla cenojnë imazhin dhe figurën publike të prokurorit dhe duhet të shmangen me vërtetësi nga subjektet e rivlerësimit dhe jo të justifikohen prej tyre.

28.3. Përpos sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk është treguar bashkëpunues gjatë hetimit administrativ, pasi ka refuzuar t'i përgjigjet pyetësorit standard të Komisionit, duke mos respektuar autoritetin e institucionit, duke u përpjekur në këtë mënyrë të pengojë dhe pamundësojë zhvillimin ndaj tij të procesit të rivlerësimit.

28.4. Bazuar në argumentet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë për shkak të qëndrimit të tij jobashkëpunues përgjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, në zbatim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, mbi vlerësimin tërësor të procedurave, trupi gjykues i Kolegjit arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

29. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 449, datë 22.09.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,



**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 449, datë 22.09.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Gina.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 12.12.2023.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

